

Ali Ahmeti
T'i përafrojmë
qëndrimet për
NATO-n dhe BE

Fq.4



**BEKTESHI
DHE DEMIRI**
Dogana
jo kundër
Maqedonisë!

Fq.5




Referen-
dumi
**Nazim
Rashidi**

Fq.10



Koha

www.koha.mk



**Kolinda puth
për Kroacinë**

Fq.11

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3417 · e enjte, 19 korrik 2018

18°C | 27°C

15 DEN

EDITORIAL

**Nota, shifër
apo dije?**



Profili i një qytetari të dinjitetshëm nuk është vetëm produkt i kompetencave sociale të formimit, por edhe të edukimit dhe kulturës së mjedisit. Te ne shkol-la është konsideruar me të drejtë vatër formimi intelektual e profesional, ndërkohë që familja - vatër e formimi moral e qytetar. Një shoqëri e shëndoshë shumë lehtë e ka t'i bashkëdyzojë këto formime, mirëpo në shoqëritë me telashe sociale ekonomike vështirë arrihet kjo... Fq.2

RAJON

**Malazezët janë
"agresivë",
mund të nisin
Luftën e Tretë
Botërore** Fq.14

GLOBI

**Bilanc
i gjendjes
së jashtëza-
konshme
në Turqi** Fq.15



KSHZ TEMA KYÇE, PUSHTETI BËN APEL PËR MBËSHTETJE

ME SY E VESHË TE REFERENDUMI



Ajo që ka komplikuar rrugën për fillimin e procesit për mbajtjen e Referendumit është vonesa në votimin e përbërjes së re të KSHZ-së. Pikërisht kjo është tema kryesore gjatë takimit të liderëve të të gjitha partive parlamentare. Por shumica mban qëndrimin se me ose pa VMRO-në, do zgjidhet KSHZ-je dhe më pas do të mbahet edhe Referendumi Fq.3

Vetëm 1/3 e popullsisë mund të jetojë si duhet

Shkup, 18 korrik - Të darkosh jashtë me familjen, të frekuentosh teatrin apo kinemanë, të bësh trajtime kozmetike, apo udhëtime e pushime vjetore është një "luks" që i vetëm 17 për qind e popullsisë ia mundëson vetes dhe familjes një herë në muaj apo në vit. Nga ana tjetër, treçerku i popullsisë nuk arrin që të plotësojë të gjitha nevojat ose të kursejë pjesë nga të ardhurat mujore. Sipas një hulumtimi online të kryer nga Instituti i analizave ekonomike Finance Think me mbi 1130 anketues të dhënat për varfërinë në Maqedoni janë dëshpëruese. Thuajse 70 për qind e popullsisë kanë deklaruar se nuk mund t'i lejojnë vetes pushim vjetor ose edhe një udhëtim në vit. Për 91 për qind të tjerë trajtimet kozmetike bëjnë pjesë tek luksi i papërbalueshëm prej tyre, 78 për qind nuk arrijnë që të blejnë asnjë veshje... Fq.6

Shkup, 18 korrik - Të darkosh jashtë me familjen, të frekuentosh teatrin apo kinemanë, të bësh trajtime kozmetike, apo udhëtime e pushime vjetore është një "luks" që i vetëm 17 për qind e popullsisë ia mundëson vetes dhe familjes një herë në muaj apo në vit. Nga ana tjetër, treçerku i popullsisë nuk arrin që të plotësojë të gjitha nevojat ose të kursejë pjesë nga të ardhurat mujore. Sipas një hulumtimi online të kryer nga Instituti i analizave ekonomike Finance Think me mbi 1130 anketues të dhënat për varfërinë në Maqedoni janë dëshpëruese. Thuajse 70 për qind e popullsisë kanë deklaruar se nuk mund t'i lejojnë vetes pushim vjetor ose edhe një udhëtim në vit. Për 91 për qind të tjerë trajtimet kozmetike bëjnë pjesë tek luksi i papërbalueshëm prej tyre, 78 për qind nuk arrijnë që të blejnë asnjë veshje... Fq.6



EDITORIAL

NOTA, SHIFËR
APO DIJE?

Emin AZEMI

Profili i një qytetari të dinjitetshëm nuk është vetëm produkt i kompetencave sociale të formimit, por edhe të edukimit dhe kulturës së mjedisit. Te ne shkolla është konsideruar me të drejtë vatër formimi intelektual e profesional, ndërkohë që familja - vatër e formimi moral e qytetar. Një shoqëri e shëndoshë shumë lehtë e ka t'i bashkëdyzojë këto formime, mirëpo në shoqëritë me telashe sociale ekonomike vështirë arrihet kjo koegzistencë. Ajo çka po i mungon me vite zhvillimit tonë është qasja ndaj formimit. Ka shumë njerëz sot që formimin e marrin rrugës, dhe kjo është shumë normale, por jo pak ka edhe prej atyre që krijojnë aureola vetëkënaqësie rreth vetes, duke refuzuar qarkullimin e ideve, si proces normal i transformimit të personalitetit. Defektet që po shfaqen në arsim, ku dija ka kaluar në grafikon numrash, po reflektohen edhe në shoqëri. Ka shumë student sot që notën mesatare luftojnë ta rrisin për të aplikuar për ndonjë bursë, e jo të përvetësojnë dije që do të jenë komplementare dhe konkurruese në një ambient më të avancuar shkencor, kulturor e social. Vrap pas numrave e jo pas dijes do të bëjë që një ditë shumë pak veta të mbërrijnë në cakun e maratonës, sepse konkurrenca që prodhon vetëm numra e ka vështirë të përballojë kërkesat e kohës.

Drita e diturisë, për të cilën u flijuan jo pak breza, do të ishte e mangët për të na kujtuar rrugën kah eci zhvillimi ynë, sikur sot të mos ishin plazmuar në shpirtndërtimin tonë disa nga vlerat e dijes dhe emancipimit. Beteja për të patur arsim kombëtar gjithmonë ishte shoqëruar me idenë madhore të Rilindësve, të cilët aksionin e tyre kulturor e politik e projektin me formën e shkronjave të bukura të alfabetit të shqipes. Dallgët e shekujve ishin munduar ti deformonin këto forma, duke nxjerrë jo rrallë në brigjet e kohës edhe trajta çoroditëse të ndërhyrjes arbitrare mbi autonominë arsimore të shqiptarëve. Duke lëvizur nga arabeskat e ngatërruara e deri te ftohtësia refuzuese e cirilikes, lavjerrësi etno-kulturor i shqiptarëve mendohej ta gjente Itakën e vet të prehjes, brenda plotnisë gjuhësore e shkrimore.

Pas shumë udhëtimeve të mundimshme, heronjtë e arsimit shqip arritën të sjellin në brigjet shqiptare edhe bankat e para ku do të cicërohej gjuha e ëmbël shqipe. Që nga Korça, Elbasani e deri në Dibër, Tetovë e Kumanovë pishtarët e diturisë krijuan skuadrën e madhe të arsimeve të arsimeve.

Sot, historinë tonë të zhvillimit do të mund ta masim me parametrat që na ofron niveli arsimor i brezave. Një arsim i konsoliduar kombëtar nuk do të ishte në shkallën adekuate të kërkesave nëse ai nuk i nënshtrohet kriterëve të mirëfillta valorizuese dhe krahasuese. Vetëdija për të patur një arsim të shëndoshë buron në nevojën që progresi shoqëror të bazohet medoemos mbi selektimin pozitiv të kuadrove të pajisur me edukim të mirëfillt shkencor e profesional.

Sfida e arsimit, është edhe sfidë e gjithë shoqërisë. Do të ishte e pafalshme që gjithë atë luftë brezash për të mbajtur gjallë arsimin shqip, përfshi edhe sakrificat titanike për themelimin e Universitetit të Tetovës, ta devalvonim duke mos ofruar një kondicion më dinamik në zhvillimin tonë arsimor.

Kuptimi për arsimin sot ka ndryshuar, bashkë me procesin e përgjithshëm të transformimeve shoqërore. Nëse në të kaluarën arsimi shqip identifikohet me qirinjtë e ndezur, që jo rrallë fikeshin nga erërat e egra barbare, sot ai duhet të jetë treguesi më i saktë që regjistron lëvizjet sejmike. Që të mos kemi dridhje të mëdha tektonike, është e domosdoshme ta konsolidojmë të sotmen dhe të ardhmen tonë me shtyllat e forta të edukimit dhe profesionalizimit Perëndimor.

MENTALITET DHE GJIRIZ PREJ KOMUNISTI

"Në vigjilje të pesëdhjetëvjetorit të demonstratave të Tetovës! Ehe, miku! Mbaj mend një mesele. Ishte viti 1970. Unë asokohe prej Sekretariatit për punë të brendshme të Tetovës, kërkoja që të pajisem me pasaportë.

Kjo kërkesë imja, u refuzua deri në motin 1975., derisa "opinga", gjegjësisht shoku im nga gjimnazi, nuk më tha: 'Në të duhet letërnjoftimi për udhëtim, detyrimisht duhesh të bashkëpunosh me mua dhe me UDB-ën!.., nëse jo atëherë, do thyesh kokën tënde'. Ia ktheva 'hazër xhevapin': Po si bëhet që unë të bashkëpunoj me përdalat-lavret e hafijeve të pushtuesit!

Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi. 'Faturat e mosnënshtrimit', qesh detyruar t'i shlyej deri në vitin 1997. Mentalitet dhe gjiriz prej komunisti", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Fadil Lushi.

RROFTË REFORMA, POSHTË DREJTËSIA!

"Duke mbështetur në çdo rast zbatimin e ligjit, natyrisht kurëre me dy dhe tre standarde, këtu nuk do të merrem me analizën e procesit të vetingut, që ka degraduar publikisht në një proces që zhvillohet në tërësi me ndonjë përjashtim rastësor, me listë dhe si hakmarrje primitive dhe gjueti shtrigash e në shenjë të urrejtjes të Edvin Kristaq Urrejtjes ndaj origjinës nga veriu apo asaj klasore të vetuarve.

Por do të theksoj këtu se me vendimet e djeshme, krye krye kreu Edvin Kristaq Rama i dha goditjen e mëshirës dhe de facto asgjësoi apo paralizoi edhe Gjykatën e Lartë të vendit, dhe së bashku me të asgjësoi edhe sistemin universal tre shkallë kushtetues të drejtësisë në Shqipëri dhe Kushtetutën e vendit e shndërroi në një letër pa vlerë. Pra për të gjithë ata shqiptarë që i thonë kushtetutës së vendit kushtetutë dhe sistemit të drejtësisë, sistem drejtësie, në Shqipëri pushteti gjyqësor i ndërtaur sipas kushtetutës si në çdo vend të lirë të botës në tre shkallë, ka rënë dhe Kushtetuta ka vdekur.

Sot narkorepublika orwelliane e Shqipërisë është i vetmi vend i planetit me sistem drejtësie me dy shkallë, pra pa shkallë të tretë. Pas paralizës së plotë të Gjykatës së Lartë, me vendimin e djeshëm të vetoreve të Edvinut, dhe pas grushtit të shtetit brenda shtetit dhe asgjësimit po me vetoret e Edvinut të Gjykatës Kushtetuese dhe shndërrimit të saj në një kadaver kushtetuese, të gjitha fuqitë e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese janë transferuar de facto në zyrat e krye krye kreut Edvin Kristaq Rama.

Me këto akte që përmbysën Kushtetutën dhe vetë rendin kushtetues të vendit, reforma e drejtësisë e realizoi qëllimin e saj sorosjan, shndërrimin e drejtësisë në Shqipëri në dege të ekzekutivit të Edvin Kristaq Ramës.

Ndaj dhe sot kriminelet e mbarë Shqipërisë, vrasësit, plaçkitësit, përdhunuesit, trafikantët, narkopolicët, narkodrejtorët, narkoçakejtë e narkoqeverisë, narkoministrat me në krye krye kreun Edvinin brohorasin me eufori të papërmbajtur 'Rroftë reforma, poshtë drejtësia!', shkruan në profilin e tij në FB, ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha.

MEDIACitate

Të huajt kanë shpenzuar rreth 1.5 miliardë dollarë në Rusi gjatë Kampionatit Botëror 2018, thotë një hulumtim i bërë nga Sberbank. Hulumtimi vuri në dukje se të huajt që kanë vizituar Rusinë gjatë Botërorit kanë shpenzuar rreth 1.5 miliardë dollarë në këtë vend. Ndërkohë në Kampionatin e Konfederatave të luajtur në vitin 2017 të huajt kishin shpenzuar 700 milionë dollarë. Në hulumtim nuk marrin pjesë biletat dhe shpenzimet në hotelet që kanë qëndruar në periudhën në fjalë.

Numri i turistëve të huaj në qytetet ku janë luajtur ndeshjet e Botërorit 2018 Moskë, St. Petersburg, Soçi, Yekaterinburg, Saransk, Rostov, Kazan, Kaliningrad, Samara, Volgograd dhe Nizhni Novgorod ka shënuar rritje prej 15 për qind, ndërsa i atyre vendas 20 deri në 25 për qind.

(Anadolu Agency, 18 korrik)



Kryetari i Vetëvendosjes Albin Kurti, mendon se Bashkimi Evropian të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet t'i pranojë në një ditë, diku në dekadën e ardhshme, ashtu sikur 10 shtete që hynë në BE, më 1 janar 2004.

"Serbia do që me një gur ti mbysë dy zogj, edhe para nesh të hyjë në Bashkimin Evropian, edhe ta krijojë bashkësinë serbe brenda Kosovës", thotë Kurti në intervistë për agjencinë Patria, duke shtuar se kjo do të ishte humbje për të gjithë rajonin.

"Nëse njëri vend hyn vetëm një ditë para tjetrit, asgjë si ka bërë Greqia Maqedonisë për një çerek shekulli, çka do të bëjmë ne këtu. A po e shihni se çka Republika Srpska po i bën B&H?", thotë Kurti. Kurti në intervistën për agjencinë Patria flet për marrëdhëniet në mes Kosovës dhe Beogradit, Kosovës dhe Bosnjes e Hercegovinës, marrëdhënies së Brukselit me vendet e rajonit dhe fatin e të gjithë rajonit.

(Patria, 18 korrik)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËRGJIRIN E LALËZIT?

Gjiri i Lalëzit (njihet ndryshe edhe si Gjiri i Shën Pjetrit) shtrihet në bregdetin shqiptar të Adriatikut midis Kepit të Rodonit (Muzhilit të Skënderbeut) në veri dhe Bishtit të Pallës në jug. Emrin e ka marrë nga fshati Lalëz që gjendet pranë bregut verilindor të gjirit. Është i hapët nga ana e detit. Gjerësia e hyrjes është 20 km, gjatësia e vijës bregdetare 35 km. Bregdeti me përjashtim të pjesëve që i përkasin Kepit të Rodonit dhe

Bishtit të Pallës është i ulët, me laguna e vende-vende moçalor (laguna e Bishtarakës). Në gjidherdhen Erzeni, përroi i Tarinit dhe ai i Vorbës. Ata depozitojnë sasi të mëdha materiale të ngurta dhe janë shkaku i ndryshimit të vazhdueshëm të vijës bregdetare të gjirit (e cila përparon në kurriz të detit) dhe e cektësisë së tij. Gjiri mbrohet mirë nga erërat veriore, por është i hapët ndaj erërave të drejtimeve të tjera.

KSHZ TEMA KYÇE, PUSHTETI BËN APEL PËR MBËSHTETJE

ME SY E VESHË TE REFERENDUMI

Ajo që ka komplikuar rrugën për fillimin e procesit për mbajtjen e Referendumi është vonesa në votimin e përbërjes së re të KSHZ-së. Pikërisht kjo është tema kryesore gjatë takimit të liderëve të të gjitha partive parlamentare. Por shumica mban qëndrimin se me ose pa VMRO-në, do zgjidhet KSHZ-je dhe më pas do të mbahet edhe Referendumi



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 18 korrik - Pas marrjes së ftesës për në NATO dhe fillimit të skringut me BE-në, muajve në vazhdim tema kryesore në vend do të jetë Referendumi për emrin e ri të shtetit. Në këtë pikë na pret një verë e nxehtë mes ty taborëve politike, pushtetit në krye me LSDM-në dhe opozitës në krye me VMRO-në, e cila ashpër është duke kundërshtuar marrëveshjen me Greqinë për emrin e ri të shtetit. Ajo që ka komplikuar rrugën për fillimin e procesit për mbajtjen e referendumi është vonesa në votimin e përbërjes së re të KSHZ-së. Pikërisht kjo është pritur të jetë tema kryesore gjatë takimit të liderëve të të gjitha partive parlamentare të mërkurën pasdite.

VMRO ka bllokuar procesin për konstituimin e KSHZ-së së re duke kërkuar amnisti për pjesëmarrësit në ngjarjet e 17 prillit, edhe pse kjo parti zyrtarisht e ka mohuar këtë. Megjithatë, këtij qëndrimi të fortë të VMRO-së, partia e Zaevit i është përgjigjur me iniciativën parlamentare për të ndryshuar Kodin Zgjedhor përmes së cilës parashikohet që përbërja e KSHZ-së të votohet me 61 vota, ndërsa fshihet edhe paragrafi 3 i nenit 27, Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të mos e shqyrtojë propozimin, ndërsa Komisioni amë të jetë Komisioni për çështje evropiane.

Ndryshe, pjesëmarrjen në takimin liderëve kanë konfirmuar nga VMRO. Në takim, siç është paralajmëruar, do të marrin pjesë lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, liderët e dy krahëve të Besës, Bilall Kasami dhe Afrim Gashi, i PDSH-së, Menduh Thaçi, i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, liderja e OBM-së, Lilja-

na Popovska, lideri i PLD-së, Goran Milevski, i PRSD-së, Tito Petkovski dhe ai i PSM-së, Lubisav Ivanov-Xingo. Siç njoftuan paraprakisht nga Qeveria, për shkak të momentit të jashtëzakonshëm politik, i cili imponon zgjerim të kornizës institucionale të takimeve të liderëve, në këtë takim në format 1+1 (lideri i parisë plus një përfaqësues i partisë politike), janë të ftuar partitë me më shumë se një deputet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.

SHUMICA E VENDOSUR NË ZGJEDHJEN E KSHZ-SË

"Nga takimi i liderëve pres që ta definojmë temën e referendumi. Kjo do të thotë që duhet ta caktojmë datën për mbajtjen e referendumin, ta definojmë pyetjen e referendumi, karakterin e referendumi, Komisionin Shtetëror Zgjedhorë dhe gjithçka që ka të bëjë me referendumin. Pres që të gjithë të tregojmë se vërtetë jemi për BE dhe NATO dhe që jemi për sigurim të ardhmërisë së Maqedonisë dhe të gjithë qytetarëve tanë", janë pritjet e kryeministrit Zoran Zaev për takimin e liderëve.

Deputetët e shumicës parlamentare mbajnë qëndrimin se takimi i liderëve do të shfrytëzohet për të larguar dallimet me VMRO sa i përket KSHZ-së. "Nëse nuk ka suksese harmonizimi i qëndrimeve me VMRO-në atëherë plotësisht kemi të drejtë sipas ligjit dhe rregullores së punës që të votojmë ndryshimet e Kodit Zgjedhor me 61 vota", thonë deputetët nga shumica parlamentare. Kundër qëndrimit të VMRO-së që po mbajnë të bllokuar zgjedhjen e KSHZ-së kanë reaguar përmes një kumtese për media nga LSDM.

"Nuk do të lejojmë që VMRO-

DPMNE-ja t'ua ndalojë të drejtën qytetarëve që të vendosin, qytetarët të thonë PO për të ardhmen e Maqedonisë", thuhet në kumtesën e Qendrës për komunikime me opinionin të LSDM-së. "VMRO-DPMNE-ja me vetëdije dhe qëllimisht e bllokoi zgjedhjen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, me çka e vendos në pikëpyetje mbajtjen e referendumi për të ardhmen e shtetit. Me këtë, VMRO-DPMNE-ja vazhdon të punojë kundër interesave të qytetarëve dhe shtetit", thonë nga LSDM. VMRO-DPMNE-ja dyfytërshe, theksojnë nga LSDM, 10 vite në secilin paraqitje të saj, në secilin program zgjedhor pohonte se qytetarët do ta kenë fjalën e fundit për zgjedhjen e kontestit me emrin.

"Sot, kur ekziston Marrëveshja përfundimtare, kur referendumi është i patjetërsueshëm, VMRO-DPMNE-ja në secilën mënyrë i ik obligimit për referendumi. Për VMRO-DPMNE-në nuk janë të rëndësishme interesat e qytetarëve, e as nuk është e rëndësishme e ardhmja e shtetit. Misioni i vetëm politik i VMRO-DPMNE-së dhe Hristian Mickoskit është amnistimi i krimi i kreut të partisë së tyre

dhe fati i Nikolla Gruevskit", thuhet në kumtesën e LSDM-së. Për vete "Askush nuk guxon dhe askush nuk do t'ua mohojë të drejtën qytetarëve për referendumi, që lirshëm të vendosin për të ardhmen e tyre. I pëlqeu kjo VMRO-DPMNE-së apo jo, Maqedonia nuk mund të bëhet rob i krimi të tyre. Qytetarët do ta thonë fjalën përfundimtare në referendumi, do të thonë PO për të ardhmen e Maqedonisë dhe për hyrje në BE dhe NATO", theksojnë nga Qendra për komunikime me opinionin të LSDM-së.

VMRO: LSDM PO NGULFAT DEMOKRACINË

Paraprakisht, VMRO përmes një kumtese për media akuzoi LSDM-së se me iniciativën për ndryshimin pa opozitë po e ngulfasin demokracinë në Maqedoni. "Sipas standardeve të Zaevit, Bujar Osmani i cili deri para një kohe ishte kriminel, tani duhet ta evropianizojë Republikën e Maqedonisë. Zoran Zaev është njeri i cili sot flet ndryshe, nesër ndryshe. Republika e Maqedonisë është viktimë e politikës së tij të bazuar në gënjeshtër, manipulime dhe tregti me interesat kombëtare. Pu-

shteti nuk brengoset as për shtetin, as për qytetarët. Zoran Zaev dhe LSDM i shkelin Kushtetutën, ligjet dhe procedurat, dhe me çdo çmim ta zbatojnë marrëveshjen për kapitullim. Ndërrimi i Kodit zgjedhor me qëllim që të anashkalohe obligimi ligjor dhe praktika e dhënë për votim në KSHZ me shumicë prej 2/3 dhe me konsultim të opozitës është mbyetje e demokracisë dhe paraqet goditje ndaj praktikës së vendosur të deritanishme e cila garanton shprehje të vullnetit të qytetarëve", thotë VMRO. Sipas kësaj partie, inkluziviteti si vlerë demokratike tërësisht është i shkelur nga Zoran Zaev, njeriu i cili premton debat për gjithçka, ndërsa tani me çdo çmim shkatërron madje edhe formën më të vogël të diskutimit.

"VMRO-DPMNE mbetet në kërkesat parimore, të vendosura dhe harmonizuara mes grupeve të punës në mars rreth konceptit për financim të partive politike dhe qeverisë sipas marrëveshjes së Përzihos, si garancion për krijimin e kushteve demokratike për procesin zgjedhor", thuhet në kumtesën e VMRO-DPMNE-së.

"NËSE KA NJË VOTË MË SHUMË KUNDËR, NE DO TË TËRHIQEMI"

Kur jemi tek Referendumi, ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, në intervistë për Al Xhezaira foli me bindje se do të kalojë me sukses dhe se qytetarët do ta ratifikojnë Marrëveshjen me Greqinë. "Nëse ka vetëm një votë më shumë kundër, atëherë ne absolutisht jemi të përgatitur të heqim dorë dhe të tregojmë se kjo nuk është rruga e vërtetë. Para dilemave të mëdha historike qytetarët ditën ta zgjedhin rrugën e duhur. Para nesh qëndron zgjedhja mes të kaluarës dhe të ardhmes. E kaluara është



mjaft e rëndësishme për identitetin tonë, por nuk mund ta ndryshojmë, mundet që përfundimisht qytetarëve t'u ofrojmë zgjidhje se çfarë shteti do të jetë Maqedonia në të ardhshmen. Nuk kishte obligim më të madh patriotik që ta krijojmë këtë mundësi dhe t'u mundësojmë qytetarëve të zgjedhin. Unë jam i sigurt se do ta zgjedhin të ardhmen", tha Dimitrov. Në lidhje me qëndrimin e opozitës, ai tha se çështja për momentin është më e rëndësishme sesa karriera dhe lojërat politike.

Bashkë për projekte tejkufitare për zhvillim të turizmit

Shkup, 18 korrik - Rajonet kufitare të Maqedonisë dhe Kosovës së bashku do të aplikojnë për grante në fonde evropiane për zhvillim të turizmit. Kjo u arrit në takim të sotëm në Shkup mes ministrit të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi dhe ministrit kosovar të Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri, ku u bë fjalë edhe për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e zhvillimit të barabartë rajonal. "Në takim i ndamë përvojat dhe mënyrën se si në Republikën e Maqedonisë financohen rajonet me qëllim që të jenë të zhvilluara në mënyrë të barabartë. U dakorduam që rajonet kufitare bashkërisht të aplikojnë në fondet e BE-së për marrje të granteve për zhvillim me qëllim që të krijohen vende të reja të punës dhe të tërhiqen turistët, posaçërisht në rajonin e Kodrës së Diellit dhe Brezovicës dhe Likovës e Gjilanit", deklaroi Bekteshi pas takimit. Ministri Demiri theksoi se ndërtimi i autostradës drejt kufirit të Maqedonisë tregon se Kosova dëshiron të ketë bashkëpunim me Maqedoninë në të gjitha nivelet. "Vizita e sotme është shumë e rëndësishme dhe çdo përvojë e transmetuar nga pala e Maqedonisë për ne është shumë e dobishme. Pas takimit të sotëm në Shkup do të formojmë grupe të punës të cilat do të punojnë në projekte të përbashkëta evropiane të financuara përmes programit IPA në sferën e turizmit. Shpresoj se së shpejti do të nënshkruajmë edhe memorandum për bashkëpunim", tha Demiri.

ANKOHET FEDERATA E INDUSTRIVE GREKE

KOMPANITË GREKE DO TA HUMBIN TERMIN MAQEDONIA

Sipas kryetarit të Federatës greke, regjistrimi i nevojshëm në organizatën botërore në Gjenevë, tanimë e kanë bërë dy kompani nga Maqedonia, ndërsa çmimi i lartë prej 8000 euro është arsyeja se pse kompanitë nuk e kanë siguruar edhe ligjërisht emrin e tyre ose emrin e prodhimeve të tyre

Athinë, 18 korrik - Kryetari i Federatës së industrive nga Greqia Veriore, Atanasios Savakis, apelon që kompanitë greke në emrin ose prodhimet e të cilave është i përfshirë termi Maqedonia ose fjalët që dalin prej këtij termi ligjërisht ta sigurojnë emrin para se të fillojë me punë komisioni për shenja tregtare, në pajtueshmëri të Marrëveshjes së Prespës, që të mos ballafaqohen me probleme në tregun ndërkombëtar, por edhe që të mos pësojnë dëme ekonomike.

Duke folur para gazetarëve grekë, Savakis, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, ka thënë se pothuajse 4000 kompani greke rrezikojnë ta humbin emrin, ndërsa nga këto vetëm 24 e kanë bërë regjistrimin e nevojshëm, por në regjistrin evropian. "Siç zbuloi kryetari i Federatës së industrive nga Greqia Veriore, Atanasios Savakis, kompanitë që e shfrytëzojnë termin Maqedonia nëse në identitetin e tyre korporativ ose në prodhimet e tyre, do të duhet, para se të fillojë procesi i formimit të Komisionit që do t'i shqyrtojë shenjat konkrete dhe e cila është paraparë me Marrëveshjen e Prespës, menjëherë të reagojnë që ta sigurojnë, në nivel ndërkombëtar, emrin e tyre", shkruan gazeta greke "To vima".

Sipas kryetarit të Federatës, regjistrimi i ne-



vojshëm në organizatën botërore në Gjenevë, tanimë e kanë bërë dy kompani nga Maqedonia, ndërsa çmimi i lartë prej 8000 euro është arsyeja se pse kompanitë nuk e kanë siguruar edhe ligjërisht emrin e tyre ose emrin e prodhimeve të tyre. Që t'u ndihmojë kompanive, Federata, sipas mediave greke, ka ndërmarrë iniciativë për ndihmë falas juridike dhe procedurale për të gjithë bizneset e interesuara. Lidhur me zgjidhjen midis Maqedonisë dhe Greqisë, Savakis ka thënë se çdo marrëveshje ka anë negative dhe pozitive, por çështja duhet të zgjidhet për shkak se shumë i kushtonte kom-

panitë greke, posaçërisht ato nga pjesa veriore e vendit. Ka shtuar se marrëveshja krijon parakushte për rritje të investimeve në Shkup, por edhe se porti në Selanik hap perspektiva të mëdha. "Nuk mundet që austriakët dhe gjermanët të marrin pjesë, posaçërisht në prodhimet ushqimore-bujqësore, ndërsa ne që jemi në 30 kilometra nga kufiri të mos mundemi", ka thënë Savakis, sipas "Katimerini"-t dhe ka shtuar se shumë kompani të cilat kanë dashur të eksportojnë tek ne, këtë e kanë bërë përmes Shqipërisë ose Bullgarisë, që në mënyrë plotësuese e ka rritur shpenzimin e tyre.

HIDHET POSHTË KËRKESA PËR SUSPENDIMIN E MARRËVESHJES SË PRESPËS

Cjykata Kushtetuese e Greqisë e hodhi poshtë kërkesën e "Federatës greke së shoqatave kulturore të maqedonasve" dhe "Asociacioneve Panmaqedonase dhe maqedonasve nga diaspora", për suspendimin e Marrëveshjes së Prespës, ndërsa kërkesa për nënshkrimin e

Marrëveshjes, do të shqyrtohet në fillim të dhjetorit, njofton korrespondentja e MIA-s. Sipas gjykatësve, në rast se Marrëveshja nuk hyn në fuqi, në tërësi apo secila prej dispozitave në veçanti, atëherë nuk do ta obligojë asnjërin prej palëve në asnjë mënyrë.

PRITJE E AHMETIT PËR FTESËN E NATO-s

T'I PËRAFRUJMË QËNDRIMET PËR NATO-n DHE BE-në

Në festën të cilën e organizoi Ahmeti për nder të NATO-s, para të pranishmëve u shfaq video prej tetë minutash në të cilën lideri i BDI-së e shpjegon përkushtimin e tij për anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancë në 17 vitet e kaluara



Shkup, 18 korrik - Vlerësoj se të gjitha forcat politike duhet të gjejnë energji për t'i përafuruar qëndrimet për qëllimet të cilat janë të njohura publikisht, ndërsa janë për realizimin e marrëveshjes me Greqinë, deklaroi dje lideri i BDI-së, Ali Ahmeti pas festës të cilën e organizoi për ftesën e marrë për anëtarësimin në NATO. Ahmeti e tha këtë duke u

përgjigjur në pyetjen e gazetarëve se çfarë pret prej takimit të mbremshëm të liderëve të cilin e caktoi kryeministri Zoran Zaev pas bllokimit për zgjedhjen e përbërjes së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili duhet ta organizojë referendumin vjeshtor për çështjen e emrit. Ahmeti shtoi se

Maqedonia nuk ka alternativë tjetër përveç anëtarësimin në NATO dhe fillimin e negociatave me BE-në dhe se kjo do të na sigurojë paqe, stabilitet dhe prosperitet ekonomik.

Sipas tij, për momentin midis shumë partive por bëhet dialog dhe ka shumë takime midis të

gjitha partive politike dhe bisedat, siç tha, tani për tani janë duke u zhvilluar në drejtim të mirë. Ahmeti nuk mendon se zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të ishin zgjidhje për këtë gjendje. Në festën të cilën e organizoi Ahmeti për nder të NATO-s, para të pranishmëve u

shfaq video prej tetë minutash në të cilën lideri i BDI-së e shpjegon përkushtimin e tij për anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancë në 17 vitet e kaluara.

"NATO ishte dhe do të mbetet një prej shtyllave kryesore si garanci për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit", tha midis tjerash Ahmeti, duke theksuar se anëtarësimi i Maqedonisë në Aleancë do t'i mundësojë asaj siguri, stabilitet dhe prosperitet më të madh... Në solemnitetin i cili u organizua me një restorant në qendër të Shkupit mori pjesë kryetari i Parlamentit, deputetët e BDI-së dhe funksionarë të lartë të kësaj partie, përfaqësues të NATO-s në Maqedoni, ambasadori amerikan Xhes Bejli dhe përfaqësues të tjerë të misioneve diplomatike në Shkup, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis Ulem Sulejman Rexhepi dhe të tjerë. (Z.V)

Sipas vendimit të Qeverisë kosovare, në listën e prodhimeve bujqësore të cilët do t'u nënshtrohen masave të përkohshme doganore janë patatja, domatja, speci, trangujt, shalqiri, pjepri, lakra e hershme (pranverore), lakra e vonshme (vjeshtore), sallata (në të gjithë variantet), spinaqi, qepa, karota, fasulja monokulturore, molla, dardha, qershia, dredhëza, mjedra, manaferra dhe misri

BEKTESHI DHE DEMIRI SQAROJNË MASAT E QEVERISË SË KOSOVËS

DOGANA KOSOVARE JO KUNDËR MAQEDONISË!



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 18 korrik - Gjatë 90 ditëve në vijim, edhe zyrtarisht do të hyjnë në fuqi masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat parashohin rritjen të doganës për 30 për qind të prodhimeve bujqësore që do të futen në tregun e Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të CEFTA-së. Për këtë masë, të cilën e miratoi një ditë më parë Qeveria Kosovës me kërkesë të Ministrisë së Tregtisë të Kosovës, ministri i Ekonomisë së Maqedonisë, Kreshnik Bekteshi informoi se edhe zyrtarisht gjatë ditës së martë më shkrim ka marrë njoftimin nga Qeveria e Kosovës se kjo masë e cila ka karakterin e përkohshëm, gjegjësisht do të zgjatë 90 ditë, aspak nuk është vendosur vetëm për prodhimet bujqësore nga Maqedonia, por se e njëjta vlen edhe për të gjitha vendet e tjera anëtare të marrëveshjes së CEFTA-së.

"Zbatimi i doganës prej 30 për qind për import të prodhimeve bujqësore në Kosovë nuk nënkupton luftë tregtare ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Masa nuk është drejtuar kundër Maqedonisë, por ka të bëjë për të gjitha shtetet e botës të cilat importojnë prodhime bujqësore në Kosovë. Duke pas parasysh të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, kemi për obligim që edhe ne të ndërmarrim

masat tona. Ato do të analizohen në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Administratën Doganore, por njëkohësisht do të shqyrtohen edhe në përputhje me Sekretariatit e CEFTA-s dhe me anëtarët dhe shtetet tjera", deklaroi Bekteshi pas takimit që realizoi të hënën në Shkup me ministrin kosovar të Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri.

Ministri Bekteshi edhe njëherë konfirmoi se pala e Maqedonisë më parë nuk ishte informuar me kohë për zbatimin e masës, mirëpo dje ka pranuar më shkrim njoftimin se masa nga dita e martë hyn në fuqi. Bekteshi shtoi se sipas Marrëveshjes së CEFTA-s, Kosova është e detyruar që me kohë t'i informojë të gjitha

vendet anëtare për qëllimin e zbatimit të doganave dhe se, si ministër i Ekonomisë, ai do të realizojë disa takime në të cilat së pari do të analizohen të gjitha implikimet e mundshme ndaj prodhimeve të Maqedonisë, ndërsa pastaj do të ndërmarr qëndrim se a do të vendosen anti-masa.

"Si Ministri i Ekonomisë dhe si Qeveri, nuk ishim të informuar, por në bisedë me Sekretariatit e CEFTA-s, kuptova se nuk ishin informuar as edhe anëtarët tjerë të CEFTA-s", tha Bekteshi. Ndërkaq ministri kosovar i Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri, theksoi se masa është zbatuar me qëllim që të mbrohen prodhuesit vendor të prodhimeve bujqësore.

"Vendimi nuk ka asgjë kundër Maqedonisë dhe qëllimi i saj është që të mbrohen prodhuesit kosovar të prodhimeve bujqësore. Mendoj se masa është analizuar mirë dhe vlerësoj se do të jetë në interes të prodhuesve tonë, ndërsa ndikimet do të jenë pozitive", tha Demiri. Sipas vendimit të Qeverisë kosovare, në listën e prodhimeve bujqësore të cilët do t'u nënshtrohen masave të përkohshme doganore janë patatja, domatja, speci, trangujt, shalqiri, pjepri, lakra e hershme (pranverore), lakra e vonshme (vjeshtore), sallata (në të gjithë variantet), spinaqi, qepa, karota, fasulja monokulturore, molla, dardha, qershia, dredhëza, mjedra, manaferra dhe misri.

VENDIMI I KOSOVËS, HAP I PAKUPTIMTË

Vendimi i Kosovës për vendosje të doganave mbrojtëse për produkte bujqësore ushqimore të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore e konsiderojnë si të pakuptimtë, respektivisht hap i gabuar nga pala tjetër, e cila mund të ketë efekt negativ në biznes, por edhe të jetë në kundërshtim me Marrëveshjen e CEFTA-s, për shkak të së cilës duhet të rihetohet. "Republika e Kosovës është partneri më i rëndësishëm i shkëmbimit tregtar me Republikën e Maqedonisë. Vendosja e masave të këtylla, që janë restriktive dhe janë në kundërshtim me tregtinë e lirë mes vendeve kuptohet që e

konsiderojmë si të pakuptimtë, gjegjësisht hap të gabuar nga pala tjetër", tha Dilon Iseni, drejtor ekzekutiv i Odës. Ai shton se ka reagime edhe nga ana e furnizuesve nga Kosova dhe se edhe ata ankohen ndaj kësaj mase. "Ata mendojnë se nuk kanë potencial nga resurset e tyre dhe t'i plotësojnë nevojat reale. Për këtë kanë qëndrim të kundërt ndaj kësaj mase", tha Iseni. Bëri thirrje që Qeveria kosovare të punojë me urtësi për tregti të lirë, sepse siç tha, kjo masë mund të shkurtohet me Marrëveshjen e CEFTA-s. Nëse Kosova nuk i plotëson detyrimet që i ka ndërmarrë, kjo mund të ndikojë në reputacionin e vendit.

KRONIKË

Rrokulliset automjet i zjarrfikësve, tre të lënduar

Tre zjarrfikës nga Njësitit territorial zjarrfikës në Qytetin e Shkupit janë lënduar pasi automjeti i tyre është rrokullisur në lagjen Maxhari të Shkupit, tek Trianglla. "Zjarrfikësat urgjentisht janë transferuar në Qendrën urgjente, janë kontaktibil dhe bëhen analiza detajore", ka thënë për MIA komandanti i Njësitit të zjarrfikësve në Qytetin e Shkupit, Zvonko Tomeski. Ekipi është dashur të intervenojë në zjarrin e një shtëpie në fshatin Haraçinë. Atje është dërguar ekip tjetër. Nga flakët është përfshirë shtëpi në Haraçinë prej 200 metra katrorë, kulmi dhe njëri kat. Automjeti i zjarrfikësve është rrokullisur nga arsye deri tani të panjohura. Në vijim është hetimi në vendin e fatkeqësisë, ndërsa pason edhe vlerësimi i dëmit.

Gjenden dy motrat e zhdukura në Probishtip

Policia mbrëmë, në orën dy, në qendër të Krushevës i ka gjetur dy personat e zhdukur nga Probishtipi, N.T. (19) dhe motrën e saj 16-vjeçare. Siç informoi MPB-ja, efektivët e policisë gjatë kontrollit të identitetit i kanë zbuluar personat e zhdukur. Vajzat më 16 korrik janë denoncuar si të zhdukura nga babai i tyre M.T. (55) nga Probishtipi. Babai ka denoncuar se vajzat e tij më 14 korrik janë larguar nga shtëpia në drejtim të panjohur. Momentalisht edhe një person rezulton i zhdukur. N.N (76) nga azili pleqve "Ruski". Rastin dje në Stacionin e policisë e ka denoncuar personi përgjegjës i azilit.

Një 11-vjeçare kafshohet nga një qen

Një vajzë njëmbëdhjetëvjeçare është kafshuar nga një qen në Kavadar, kumtoi sot zëdhënësi i SPB Veles Veroljub Dodevski. Rastin në polici e ka denoncuar V.P, babai i vajzës. "Ngjarja ka ndodhur në rrugën "Pano Mudarov" në afërsi të shtëpisë së tyre. Qeni ka qenë racë e panjohur.

Përplaset 72-vjeçarja, shoferi ik nga vendi i ngjarjes

Shtatëdhjetë e dy vjeçarja shkupjane M.A. dje ka marrë lëndime të rënda trupore në aksident trafikësor pasi një veturë "Audi" me targa italiane nga një person i panjohur, ka goditur atë, ndërsa pas fatkeqësisë e ka braktisur vendin e ngjarjes. Siç kumtoi MPB, aksidenti ishte denoncuar dje në orën 10:55 në Sektorin për punë të brendshme Shkup, ndërsa kishte ndodhur në udhëkryqin e bulevardit "Goce Dellçev" me rrugën "1732".

"Në fatkeqësinë lëndime ka marrë M.A. e cila me veturë të Ndihmës mjekësore urgjente ishte dërguar në Komplexin e klinikave "Nëna Terezë" për dhënien e ndihmës mjekësore dhe nga ana e mjekut i ishin konstatuar lëndime të rënda trupore, pas çka ishte ndaluar për mjekim të mëtutjeshëm", theksojnë nga MPB. Po ndërmerren masa për zbardhjen e plotë të rastit. (O.Xh)

Shkup, 11 aksidente për 24 orë

Shkup, 18 korrik - Një këmbësor dhe një shofer kanë marrë lëndime të lehta në dy në gjithsej 11 aksidente të regjistruara në ditën e djeshme. Në pesë aksidente janë lënduar më lehtë nëntë persona, ndërsa në katër është shkakuar dëm material. Nga MPB informojnë se policia e tra-

fiku ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. dyzet e tre shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, pesë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, gjashtë shoferë për renditje në mënyrë të parregullt, si dhe tre shoferë të cilët nuk kanë

mbajtur kaskë në motoçikletë. Janë sanksionuar edhe shtatë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimeve për këmbësorë dhe gjashtë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe. Nga trafiku janë përjashtuar dy shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikim të

alkoolit, tetë shoferë sepse kanë drejtuar automjetin para se ta marrin të patentën, si dhe 12 automjete të parregjistruara. Janë hasur 59 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 61 automjete.

Më së shumti ankesa për internetin

Shkup, 18 korrik - Numri i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve elektronike të komunikimit në Maqedoni shënon rritje në krahasim me vitin 2017, theksohet në raportin e publikuar të Agjencisë për komunikime elektronike (AKE) nga testimi i mendimit publik nga aspekti i mbrojtjes së shfrytëzuesve të shërbimeve elektronike të komunikimit/shfrytëzues rezidencial. Sipas sondazhit, të zbatuar nga 31 maji deri më 14 qershor të këtij viti tek 1100 të anketuar, përmes telefonit më së shumti janë ankuar shfrytëzuesit e internetit - 32.6 për qind e amvisërive në të cilët janë shfrytëzues, pas çka vijojnë për televizion - 22.5 për qind të amvisërive në të cilët shfrytëzohet shërbimi i operatorit, pra për telefoni fiskale - 12.5 për qind e shfrytëzuesve. Më së paku përmes telefonit janë ankuar shfrytëzuesit e shërbimit të telefonisë mobile - 11.8 për qind. Ankesa me shkrim, megjithatë më së shumti shfrytëzuesit e telefonisë fikse - 1.9 për qind, pas tyre vijojnë amvisëritë në të cilat shfrytëzohet shërbimi i internetit me 1.7 për qind dhe shërbimi i televizionit me 1.4 për qind të amvisërive në të cilat shfrytëzohen ato shërbime. Për telefoni mobile është ankuar më së shumti edhe me ankesa me shkrim, gjegjësisht 1.1 për qind të amvisërive. Sipas analizës, të zbatuar vitin e kaluar, tek secila prej shërbimeve elektronike të komunikimit ka rritje të lehtë të shfrytëzuesve me përjashtim të televizionit i cili gradualisht bien që nga viti 2016. Shumica e shfrytëzuesve janë të kënaqur nga çmimet dhe nga cilësia e shërbimeve, me ç'rast e gjithë kënaqësia (shuma e përgjigjeve "jam shumë i kënaqur" dhe "jam i kënaqur") nga cilësia është më e madhe tek shërbimet fikse telefonike (85 për qind) pastaj vijojnë shërbimet televizion (76 për qind), telefoni mobile (76 për qind) dhe internet (74 për qind). Në përgjithësi, kënaqësi nga çmimet e shërbimeve të telekomunikimit në vitin 2017 shënojnë rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak, përveç tek shërbimi i televizionit, ku ulet kënaqësia nga vitin paraprak 2017, për nëntë për qind. Më shumë kënaqësi nga çmimet vërehet tek shfrytëzuesit e telefonisë fikse (79 për qind) pas çka vijojnë shfrytëzuesit e internetit (71 për qind), pastaj shfrytëzuesit e telefonisë mobile dhe televizionit me nga 70 për qind.

Treçereku i popullsisë nuk arrin që të plotësojë të gjitha nevojat ose të kursejë pjesë nga të ardhurat mujore. Për pjesën dërmuese (mbi 78 për qind) të ardhurat bazë janë rroga mujore, apo pensioni, pjesa tjetër që nuk ka asnjë të ardhur mbështetet tek burimet financiare të prindërit, bashkëshortit, të afërmeve që jetojnë jashtë vendit, ose ndihmës sociale nga shteti

Koha

Evis HALILI

Shkup, 18 korrik - Të darkosh jashtë me familjen, të frekuentosh teatrin apo kinemanë, të bësh trajtime kozmetike, apo udhëtime e pushime vjetore është një "luks" që i vetëm 17 për qind e popullsisë ia mundëson vetes dhe familjes një herë në muaj apo në vit. Nga ana tjetër, treçereku i popullsisë nuk arrin që të plotësojë të gjitha nevojat ose të kursejë pjesë nga të ardhurat mujore. Sipas një hulumtimi online të kryer nga Instituti i analizave ekonomike Finance Think me mbi 1130 anketues të dhënat për varfërinë në Maqedoni janë dëshpëruese.

Thua se 70 për qind e popullsisë kanë deklaruar se nuk mund t'i lejojnë vetes pushim vjetor ose edhe një udhëtim në vit. Për 91 për qind të tjerë trajtimet kozmetike bëjnë pjesë tek luksi i papërbalueshëm prej tyre, 78 për qind nuk

ANKETË ONLINE E FINANCE THINK

VETËM 1/3 E POPULLSISË MUND TË JETOJË SI DUHET



arrijnë që të blejnë asnjë veshje të re, apo këpucë një herë në muaj, 76 për qind nuk mund të udhëtojnë çdo ditë me automobil, 4 për qind kursejnë duke mos arritur të përbushin asnjë lloj kënaqësie. Sa i takon kulturës 68 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se nuk mund të përballojnë të blejnë asnjë herë në muaj një biletë për në teatër apo kinema, ndërsa thuhet 60 për qind e të anketuarve mund arrijnë të drekojnë asnjë herë në muaj në restorant.

Sipas hulumtimit, vetëm një e treta e popullsisë arrin që të plotësojë të gjitha nevojat, ose të kursejë nga të ardhurat mujore. Mbi 42 për qind të tjerë arrijnë vetëm të

plotësojnë nevojat më elementare, për tu ushqyer dhe për të paguar fatura, ndërsa pjesa tjetër, 28 për qind nuk arrijnë as këto kërkesa t'i plotësojnë. Për pjesën dërmuese (mbi 78 për qind) të ardhurat bazë janë rroga mujore, apo pensioni, pjesa tjetër që nuk ka asnjë të ardhur mbështetet tek burimet financiare të prindërit, bashkëshortit, të afërmeve që jetojnë jashtë vendit, ose ndihmës sociale nga shteti.

Thellimi i hendekut të varfërisë, sipas të dhënave të Financial think vjen edhe si pasojë se dallimeve të mëdha tek të ardhura financiare. Sipas statistikave 445 mijë persona në vitin 2016 kanë je-

tuar nën pragun e varfërisë, ose me të ardhura vjetore që nuk kalojnë 82.560 mijë denarët (familje me një anëtar), ndërsa për ato me katër anëtarë të ardhurat vjetore arrijnë deri në 173.376 mijë denarë në vit.

Gjysma e të punësuarve në Maqedoni marrin paga që nuk arrijnë as 200 euro, ndërsa gjysma tjetër marrin paga prej 200 deri 400 euro. Sipas analizave të Institutit mbi 43 për qind e të punësuarve në Maqedoni marrin paga më të vogla se 12 mijë denarë, vetëm 8 për qind marrin paga më të mëdha se 25 mijë denarë, ndërsa gjysma e të punësuarve marrin paga prej 12 deri 25 mijë denarë.

PAK INTERESIM PËR SOFTUERIN E KONTROLLIT PRINDËROR

90 për qind e familjeve nuk i kontrollojnë fëmijët në internet!

Shkup, 18 korrik - Vetëm 10.1 për qind e amvisërive në Maqedoni me persona minorene kanë instaluar softuer për kontroll prindëror, tregon Raporti i publikuar dje i Agjencisë për komunikime elektronike (AKE) nga hetimet e mendimit publik nga aspekti i mbrojtjes së shfrytëzuesve të shërbimeve komunikuese elektronike për shfrytëzues rezidencialë. Më shumë se gjysma e të anketuarve (58 për qind) në shtëpitë e të cilëve, minorenet kanë qasje në internet nuk janë koshient se ekziston softuer për kontroll prindëror që fëmijëve do t'u mundësojë internet të sigurt. Dyzet e katër për qind e personave në amvisëri që momentalisht nuk kanë softuer të këtillë janë të interesuar që ta instalojnë në të ardhmen, në pjesën më të madhe (87,5 për qind) e tyre nuk dinë ku mund të blejnë një softuer të këtillë. Përqindja e fëmijëve minorene që kanë qasje në internet (30 për qind) shënon rënie të vogël në krahasim me vitin 2017. Në 83



për qind e rasteve fëmijët në internet qasen çdo ditë dhe në të zakonshist 37.5 për qind kalojnë në deri në dy orë dhe 43.1 për qind nga dy deri në pesë orë (në mënyrë kumulative 80.6 për qind). Në Maqedoni, qasje në internet në shtëpi kanë 84,5 për qind, ndërsa shfrytëzuesit e internetit janë 76.8 për qind e popullatës. Një e treta e amvisërive me qasje në internet kanë dërguar ankesa telefonike deri te provajderi i tyre edhe në 90 për qind nga

rastet përgjigjja e operatorit ka qenë e kënaqshme për personin që është ankuar. Vetëm 1,7 për qind e amvisërive me qasje në internet kanë dërguar ankesa me shkrim deri te internet provajderi, numri më i madh (75 për qind) për cilësinë e shërbimit. Sipas anketimeve, rritet numri i personave që janë të kënaqur nga shpejtësia e internetit, kështu që përqindja e përgjithshme e personave të kënaqur (shumë prej "shumë të kënaqur"

dhe "jam i kënaqur") është rritur për 1.2 për qind në krahasim me vitin 2017. Pjesa më e madhe e shfrytëzuesve në internet (66 për qind) nuk e dinë se ekziston mundësia që të matet shpejtësia e saktë që e ka furnizuar internet provajderi, ndërsa 42 për qind e tyre që janë koshient për këtë mundësi e verifikojnë shpejtësinë e internet lidhjes së tyre. Tridhjetë dhe dyzet për qind e të anketuarve që kanë qasje deri në internet e kanë kontaktuar provajderin për shkak të ndërprerjes apo mungesës së shërbimit në 12 muajt e fundit, ndërsa tek 54 për qind e tyre problemi është zgjidhur ditën e njëjtë. Anketa është zbatuar në periudhën nga 31 maji deri më 14 qershor të këtij viti, në ekzemplar të rastësishëm reprezentativ prej 1000 të anketuarve nga popullata e moshës prej 18 e më tepër, shfrytëzues të ndonjëris nga shërbimet elektronike komunikuese: telefoni fikse, telefoni mobile, internet dhe televizion.

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore vlerëson se Ligji që hyri në fuqi më 7 korrik, e që ka të bëjë me parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit, si i tillë, do të shkaktojë probleme të mëdha në biznesbërje

OEMVP ANKOHET ME LIGJET QË DËMTOJNË BIZNESET

TË ANULOHET LIGJI PËR PARANDALIMIN E LARJES SË PARAVE



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 18 korrik - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore vlerëson se Ligji që hyri në fuqi më 7 korrik të këtij viti, për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit, do të shkaktojë probleme të mëdha në biznesbërje. Bile, në OEMVP mendojnë se dispozitat e tij janë shumë më restriktive në Maqedoni, sidomos në ndalesat e pagesave në kesh prej 2000 euro në raport me 15 mijë euro në raport me shtetet e tjera anëtare të BE-së, apo shtetet kandidatë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

"Ne rekomandojmë që të prolongohet zbatimi i Ligjit për një afat të pacaktuar, të konsultohen bizneset për këtë ligj kaq të ndjeshëm për biznes eko-sistemin e jo të sillen ligje me procedurë të përsheptuar. Duhet të bëhet analizë e

detajuar se si i njëjti do të ketë ndikim në jetën reale të të gjithëve, si dhe të trajnohen kompanitë për Direktivën 2015/849 dhe të informohen qytetarët dhe bizneset se si do të funksionojë ky sistem", thotë drejtori ekzekutiv i OEMVP-së, Drilon Iseni. Sipas tij, potencial i rrezikshëm për larjen e parave paraqesin lojërat e fatit në të cilin rast, shtetet duhet të zbatojnë masa për analizë të klientëve për transaksione të vetme në vlerë prej 2000 eurove ose më shumë. Me Ligjin aktual, organizuesit e lojërave të fatit nuk janë të ekspozuar

ndaj këtyre rregullave që do të thotë se tek ata - pagesat e klientëve nuk janë të obliguar t'i bëjnë nëpërmjet llogarive bankare.

Nga OEMVP e vlerësojnë lartë punën e institucioneve shtetërore për harmonizimin e legjislacionit të shtetit me atë të Bashkimit Evropian, si dhe të transponimin e Direktivës 2015/849 për pengimin dhe shfrytëzimin e sistemit financiar për qëllime larje parash dhe financimin e terrorizmit, si dhe shprehin mbështetje dhe gatishmëri për partneritet me institucionet

shtetërore në rrugëtimin e përbashkët drejt integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Megjithatë, në frymën e këtij, rrugëtimi dhe rëndësia që kanë ligjet e BE-së, në OEMVP vlerësojnë se ky ligj do të sjell implikime të ndryshme legjislative, si dhe do të ketë ndikim në veprimin afarist të bizneseve. Analizat e OEMVP tregojnë qartë se për këtë ligj, Maqedonia nuk është shërbyer me praktikën e BE-së, sepse aty vlera maksimale e pagesave me para të gatshme arrin vlerën prej 10.000 eurove.

"Kjo ulje drastike e shumës prej

15.000 në 2000 euro do të vështirësojë bërjen e biznesit në vend. Ky konstatim është marrë në bazë të anketës së realizuar nga Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim pranë OEMVP-së, prej ku 86.7 për qind e anëtarëve e vlerësojnë këtë Ligj si të dëmshëm në sferën e bërjes së biznesit. Duke luftuar për të minimizuar ekonominë joformale, kjo mund të shpie edhe deri të asgjësimi i tyre, që nuk do të ishte në interes të vendit sepse me rëndësi është që joformalja të bëhet formale dhe të konkurrojë në treg me të gjithë pjesëmarrësit tjerë dhe sigurisht, të paguajnë tatimet e jo të asgjësohet", thekson më tej Iseni. Sipas tij, vështirësitë në zbatimin e Ligjit do të hasen edhe në pjesën e formalizimit të procedurave për përgatitje të vlerësimeve të rreziqeve nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit, masave për analizë të klientëve dhe identifikimit. Nga OEMVP thonë se nevojitet të rishqyrtohen edhe e dispozitat kundërvajtëse, të cilat parashohin gjoba në vlera shumë të larta, e të cilat do të jenë të vështira edhe për kompanitë e mëdha, e jo më për kompanitë e vogla dhe të mesme që aktualisht e dominojnë biznesin në shtet.

PAJISJE TË REJA PËR KLINIKËN E GJINEKOLOGJISË

MJEK TË MIRË KEMI, POR MUNGOJNË TRAJNIMET

Van den Berg informoi gjithashtu se falë ndihmës së "Projektit Hope", në Gjermani dhe Holandë tashmë janë dërguar disa mjekë e të cilët po mësojnë procedurat e reja që ende nuk janë përdorur në Maqedoni



Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 18 korrik - Do të bëhet vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të sallave të lindjeve dhe gjendja e pajisjeve në shtet me qëllim për t'i përforcuar kushtet. Do të sigurohen edhe paketat standarde, do të ofrohen pajisje për departamentet gjinekologjike dhe pediatrike në Spitalin Klinik në Tetovë dhe Spitalin e Përgjithshëm në Kumanovë me vlerë mbi 200 mijë

dollarë. Kështu ka paralajmëruar të mërkurën ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili në bashkëpunim me organizatën "Projekti Hope", do të sigurojë pajisje të reja për Klinikën pediatrike për sëmundje të fëmijëve në zonën e pajisjeve të njësisë së kujdesit intensiv, duke përfshirë edhe një monitor të veçantë transporti për pacientët që janë të pajtueshëm për rezonancë magnetike, si dhe një

Stacion qendror për monitorimin e pacientëve, në vlerë prej 70 mijë dollarë.

Ai vuri në dukje se në bashkëpunim me përfaqësuesit e "Projektit Hope", Ministria e Shëndetësisë do të organizojë edhe punëtori për rieduktimin për vdekshmërinë së nënës dhe foshnjave në vend, ku do të përfshihen të gjitha organizatat që punojnë në Maqedoni. Matjet nga analizat e bëra për

vdekshmërinë e foshnjave të rezultateve të Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ka thënë ministri, tashmë janë kryer. Në ndërkohë, përfaqësuesi i "Projektit Hope", Jan Van den Berg, theksoi se për dy vjet e gjysmë punojnë në projekt në Maqedoni dhe kanë pasur trajnime për reduktimin e vdekshmërisë dhe sëmundjeve të sapolinurit. Ai tha se kanë mision të takohen me organizatat e tjera si

UNICEF-i që ndajnë të njëjtin qëllim, në mënyrë që të mos mbivendosen në projektet e kujdesit shëndetësor. Van den Berg tregoi edhe rolin e tij që ka në Maqedoni për të ndihmuar vendin në zgjidhjen e problemeve që kanë hasur shumë vite më parë edhe në Holandë. Ai tha se Maqedonia ka probleme me pajisjet dhe trajnimin e personelit mjekësor, i cili ka një rol të madh në të gjithë këtë. Van den Berg informoi gjithashtu se falë ndihmës së "Projektit Hope", në Gjermani dhe Holandë tashmë janë dërguar disa mjekë e të cilët po mësojnë procedurat e reja që ende nuk janë përdorur në Maqedoni.

"Mjekët në Maqedoni kanë njohuri të mëdha, por ende nuk janë fokusuar në trajnime ose pak trajnohen në mënyrë që ata të mund të përvetësojnë të gjitha procedurat në shëndetësi", u shpreh Van den Berg, pasi organizata "Projekti Hope" dhuroi pajisje për kujdesin intensiv në Klinikën e Fëmijëve.

POLLOG, 12 AKSIDENTE PËR NJË DITË

VERA SJELL KAOSIN NË KOMUNIKACION

Ditëve të fundit haset në më shumë vështirësi nga ana e vozitësve në dalje të Tetovës për në Jazhincë, ku krijohet një kaos i vërtetë për shkak të numrit enorm të veturave, por edhe automjeteve të rënda që qarkullojnë në këtë aks rrugor për në Komunën e Tearcës dhe në vendkalimin kufitar Jazhincë



Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 18 korrik - Në rajonin më të gjerë të Tetovës dhe Gostivarit, gjatë kësaj jave dukshëm është rritur frekuentimi i përgjithshëm në trafik, që është karakteristike për gjysmën e dytë të muajit korrik. Dinamika e rritur nëpër rrugë, krahas tjerave është edhe shkaktarë për ndodhjen e aksidenteve të trafikut, ku më së shumti si rezultat i shpejtësisë së papërshtatshme, gjegjësisht vozitjes së shpejtë, parakalimit të parregullt dhe mosmbajtjes së anës. Gjatë ditës së martë, në këtë rajon kanë ndodhur gjithsej 12 aksidente, me 24 persona të lënduar. Vetëm tre nga aksidentet kanë përfunduar me dëme materiale, derisa në të gjitha tjerat - pasojat kanë qenë më serioze. Duke marrë parasysh se ditëve në vijim do të rritet edhe më shumë frekuenca e vetura-

ve, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë përsëri apelon deri te vozitësit të respektojnë shenjat e komunikacionit, të respektohen rregullat dhe dispozitat ligjore, dhe tu përmbahen urdhrave dhe udhëzimeve të pjesëtarëve të policisë. Sipas policisë, edhe gjatë ditëve në vijim do të rritet numri i automjeteve të këtitilla, prandaj policia apelon për më shumë kujdes sidomos në rrugët regjionale dhe ato më të frekuentuara brenda në qytet. Më tej, nga Policia e Tetovës, apelojnë që gjatë kohës së vozitjes të mos përdoret alkool.

"U këshillohet vozitësve që të mos konsumojnë alkool gjatë kohës kur drejtojnë automjetin, të mos vozisin kur janë të lodhur, dhe në kohë të bëjnë kontrollin teknik të automjetit, sidomos nëse udhëtojnë në relacione më të gjata. Në ndërkohë, nëse ndodhin aksidente me dëme më të vogla materiale, pjesëmarrësve u rekomandohet që sa më shpejtë të përgatisin të ashtuquajturin 'ra-

port evropian' dhe të largojnë veturat nga rruga që të mos pengojnë qarkullimin e lirë të automjeteve. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me aksidentet ku marrin pjesë veturat me targa të mërgimtarëve, veturë që nuk është e regjistruar, apo ai që qarkullon automjetin pa leje për qarkullim, por për të gjithë pjesëmarrësit pa dallim", thonë nga Policia e Tetovës. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, gati se në masë të madhe i ka përforcuar aktivitetet preventive dhe kontrolluese, ku në qendër të vëmendjes janë shpejtësia, drejtimi pa leje për vozitje, gjendja teknike e veturave pjesëmarrëse në trafik, si dhe parkimi jo i rregullt. Të gjithë kundërvajtësit që do të zbulohen gjatë këtyre aktivitetëve, do të ballafaqohen me fletëpagesa të detyrueshme dhe për kundërvajtje. Sanksionet e parapara me ligj, gjegjësisht gjatë lëvizin prej 20 deri 400 euro, në kundërvlerë të denarit, si dhe masa mbrojtëse "ndalesë" në kohëzgjatje prej 3

deri 12 muaj. Qyteti i Tetovës zakonisht gjatë muajve të verës pothuajse paralizohet tërësisht kur edhe dyfishohet numri i veturave që marrin pjesë në komunikacion. Ardhja e mërgimtarëve me vetura në vendlindja dukshëm rrit frekuentimin në rrugët e Tetovës, në të cilët komunikacioni zhvillohet me shumë vështirësi. Periudha që pason pritet të jetë edhe më vështirë për shkak të ardhjes së mërgimtarëve në vendlindje kur në rrugët e Tetovës ka me mijëra vetura. Të gjitha rrugët në periudhën e verës janë të paralizuara dhe të bllokuara nga numri i madh i automjeteve në rrugë të ngushta në qytetin e Tetovës. Ditëve të fundit haset në më shumë vështirësi nga ana e vozitësve në dalje të Tetovës për në Jazhincë, ku krijohet një kaos i vërtetë për shkak të numrit enorm të veturave por edhe automjeteve të rënda që qarkullojnë në këtë aks rrugor për në komunën e Tearcës dhe në vendkalimin kufitar Jazhincë.

Komunat shpenzojnë shumë pak për furnizimet publike

Shkup, 18 korrik - Komunat vitin e kaluar kanë shpenzuar 80 milionë euro për furnizime publike, që është për 44 për qind më pak nga viti paraprak, tregon baza me të dhëna për të gjitha furnizimet e komunave që e publikoi Qendra për komunikime civile. Baza me të dhëna për tenderët komunalë për tre vitet e fundit zbulon një hendek të madh midis vlerës së furnizimeve të komunave. "Vetëm dhjetë komuna kanë shpenzuar

për furnizime publike gjysmën nga paratë që i shpenzojnë të gjitha komunat së bashku, gjegjësisht rreth 42 milionë euro. Edhe tek kompanitë është vërejtur koncentrim i njëjtë. Pesë kompanitë e para me vlerë më të madhe të kontratave për marrëveshje publike së bashku marrin pjesë me 22 për qind në vlerën e përgjithshme të furnizimeve të komunave", informon Qendra për komunikime civile. Baza i përmban të gjitha 2737

marrëveshjet për furnizime publike të arritura midis 80-të komunave dhe Qytetit të Shkupit me 1.048 kompani. Mundëson kërkim të tenderëve nëpër komuna dhe nëpër kompani, si dhe kontrollë grafite të pjesëmarrjes së kompanive në furnizimet të çdo komune individualisht. ofron të dhëna për pjesën e furnizimeve në buxhetet e komunave, si dhe për vlerën e furnizimeve për kokë banori. Baza e furnizimeve publike të komu-

nave është pjesë e dhjetë hulumtimeve dhe bazave të parapara të të dhënave për shpenzimin e parave publike të cilat do të realizohen në kuadër të projektit "Shpenzim publik për të mira publike", të mbështetur nga projekti i USAID-it për pjesëmarrje civile. Qëllimi i projektit që e zbaton Qendra për komunikime civile është rritja e efikasitetit të shpenzimit publik përmes uljes së korrupsionit dhe rritjes së transparencës.

KRONIKË

Dy tetovarë mashtrohen për punë në Gjermani

22 vjeçarja S.M dhe 21 vjeçari F.F nga Tetova, të martën kanë denoncuar mashtrim nga një femër nga Shtipi, me të cilën janë njohur në rrjetin social Facebook, gjatë muajit mars të këtij viti e cila u ka premtuar dhe garantuar punë tre mujore në Gjermani. Më pas, femra nga Shtipi, ka kërkuar nga ata që t'i paguhen nga 2700 denarë dhe nga 12.200 denarë për marrëveshjet për punë, ndërsa biletat e aeroplanit vetë do ti paguajnë. Të denoncuarit, kanë aplikuar dhe i kanë paguar mjetet, por para se të shkojnë në Gjermani, më 11 qershor, kanë marrë mesazh nga se nuk mund të shkojnë dhe më pas nuk u është lajmëruar në telefon dhe nuk ua ka kthyer paratë. Punohet në zbardhjen e rastit.

Gjendet predhë artilerike në Gostivar

42 vjeçari J.S nga Gostivari, të hënën mbrëma rreth orës 20, ka denoncuar se në lumin e fshatit Sërbinovë, ka gjetur një predhë artilerike e kalibrit 100 milimetër, e cila sipas analizave daton që nga Lufta e Dytë Botërore. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes, ndërsa granata është fotodokumentuar dhe është marrë nga ana e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për procedurë të mëtejshme.

Vjehrra denoncon nusen e humbur

Të martën, 40-vjeçarja P.E. nga fshati Banjicë e Poshtme e Gostivarit, ka denoncuar se të hënën, rreth orës 11.00 në drejtim të panjohur është larguar reja e saj M.A. 34-vjeçe nga Gostivari. Merren të gjitha masat dhe aktivitetet për gjetjen e 34 vjeçares M.A.

Aksident në Gostivar, lëndohet motoçiklisti

Të martën rreth orës 13 e 20 minuta, në rrugën "Vllazërim Bashkimi" në Gostivar, ka ndodhur aksident trafiku, në të cilën pjesëmarrës kanë qenë vetura e tipit "Pezho Partner" me targa të Gostivarit, e drejtuar nga 58-vjeçari I.N. nga Gostivari dhe motoçikletë e tipit "Jamaha" pa targa të cilin e ka drejtuar 21 vjeçari R.A. nga Gostivari. Në aksident, lëndime të rënda trupore ka marrë motoçiklisti R.A. I cili pas marrjes së ndihmës mjekësore në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murad", të Gostivarit, është transferuar në klinikat e Shkupit për mjekim të mëtejshëm. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e shkakut të aksidentit dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur. (U.H)

QYTETI I SHKUPI ME PROJEKTE AMBICIOZE

TUNELET NËN KALA, ZGJIDHJE PËR KAOSIN NË ÇAIR

Ndërtimi i rrugës së re nën Kala, sipas analizave paraprake, në masë të madhe do ta reduktonte komunikacionin në rrugën "Cvetan Dimov", e cila për momentin paraqet një ngarkesë tejet të madhe për qytetarët e Shkupit



SALLA E RE NË SARAJ ME NDIHMËN E QYTETIT TË SHKUPI

Shkolla e mesme në Saraj të Shkupit, e ndërtuar vite më parë, së shpejti pritet të bëhet edhe me sallë sportive. Për ndërtimin dhe financimin e kësaj salle, Qyteti i Shkupit ka diskutuar në mbledhjen e fundit ku është vendosur që 60 për qind e harxhimeve të kësaj salle të mbulohen nga buxheti i Qytetit,

ndërsa pjesa tjetër nga Komuna e Sarajit. Ndërtimi i kësaj salle në Saraj është e një rëndësie të veçantë për nxënësit, në suaza të së cilës pritet ti kryejnë aktivitetet edukative-sportive. Sallë tjetër sportive, e cila është në pritje e sipër të ndërtimit, është ajo te shkolla e mesme "Cvetan Dimov" në Çair.

Shkup, 18 korrik - Kaosi dhe pritjet e gjata komunikacionin rrugor në Shkup mendohet të zgjidhet përmes planeve të vjetra urbanistike. Projektin e shumë përfolur për hapjen e tuneleve për komunikacion nën Kala të Shkupit, ide kjo e cila daton që nga periudha pas tërmetit katastrofal të vitit 1963, së fundmi e ka aktualizuar kryetari Petre Shilegov.

Qëllimi i administratës së re të Qytetit të Shkupit është që pjesa veriore e kryeqytetit të ketë lidhje të re me qendrën dhe pjesën e mbetur të saj. Planet fillestare të Qytetit të Shkupit janë që bulevardi "Shën Klimenti i Ohrit", që kalon përreth godinës së Qeverisë, të vazhdojë tutje përmes parkingut që gjendet afër, mbi urat e reja që mendohet të ndërtohen, përreth ndërtesës së Doganave të Maqedonisë e drejtë nën tunelet e Kalasë. Gjatësia e kësaj rruge ambicioze që synon ta ndërtoj Qyteti i Shkupit, pritet të jetë deri në 180 metra dhe e njëjta do të kalojë nën Muzeun Bashkëkohor të Artit, respektivisht dalja-hyrja e tij do të lidhet në njërin prej udhëkryqeve të rrugës së Plastikëve. Meqë fillimi i punimeve për hapjen e tuneleve për komu-

nikacionin nën Kala, përfillet se do të nisin vitin e ardhshëm, gazeta KOHA kërkoi përgjigje nga Qyteti i Shkupit për rrjedhën e procedurës dhe përgatitjeve në përgjithësi. Duke mos theksuar se sa do të kushtojë i gjithë projekti dhe për sa kohë pritet të përfundojë i njëjti, autoritetet e Qytetit të Shkupit thonë se për momentin janë duke përfunduar përgatitje për shpalljen e thirrjes publike për përpunimin e projektit ideor. "Pas përgatitjes së projektit urbanistik dhe vendimeve infrastrukturore, saktë do të dihet itinerari i kësaj rruge, përfshi edhe koston e projektit. Po ashtu, gjatë përpunimit të dokumentacionit teknik do të përgatiten dhe analiza gjeomekanike të tokës, gjegjësisht në rast se haset në ndonjë pengesë, me automatizëm do të ofrohen alternativa në planin dokumentues, i cili është në përgatitje e sipër", thonë nga Qyteti i Shkupit. Ndërtimi

i rrugës së re nën Kala, sipas analizave paraprake - në masë të madhe do ta reduktonte komunikacionin në rrugën "Cvetan Dimov", e cila për momentin paraqet një ngarkesë tejet të madhe për qytetarët e Shkupit.

Kolonat e gjata që krijohen në orët e pasdites në këtë pjesë të qytetit, fatkeqësisht nuk po zgjidhen me dekada të tëra. Kësisoj, nisma për hapjen e një rruge të re që do ta lidhe qendrën Shkupit me Komunën e Çairit, Butelit dhe atë të Shuto Orizarës, paraqet një shpresë për shumë banorë të kësaj ane, të cilat shpeshherë ballafaqohen me ngarkesë psikologjike kur qarkullojnë nëpër rrugët aktuale.

Rinovimi i Rrugës së Plastikave dhe asaj të të "Makedonska Kosovska Brigada" është paraparë të bëhet me buxhetin e këtij viti të Qytetit të Shkupit, gjegjësisht në të ardhmen këto dy rrugë pritet të

jenë arteria kryesore që do të kryeqytetin mes vete. Ndryshe, sipas të dhënave zyrtare, plani për hapjen e këtyre tuneleve nën Kala, fillimisht është përfshirë në Planin Detal Urbanistik të Komunës Qendër, të vitit 1965, më pas i njëjti është vërtetuar në vitin 1985 dhe debati i fundit për ndërtimin e kësaj rruge është përfolur në vitin 2002. Inxhinier dhe ekspert të ndryshëm të fushës së ndërtimitarisë së rrugëve kanë potencuar se realizimi i këtij projekti është i mundshëm pasi toka nën Kala është tejet e butë dhe e përpunueshme. Megjithatë, vullneti dhe këmbëngulja institucionale për këtë projekt mbetet faktor kryesor për ndërtimin e saj. Përveç reduktimit të komunikacionit në pjesën e Çairit dhe Butelit, kjo rrugë mendohet se do të zgjidh kaosin edhe në udhëkryqin te kompleksi i Gjykatave, për ku thuhet se brenda ditës kalojnë mbi 85 mijë vetura.

Roamingun nuk e dinë një e treta e shfrytëzuesve

Shkup, 18 korrik - Pothuajse një e treta (29 për qind) e shfrytëzuesve nga Maqedonia nuk e dinë tarifën kur e shfrytëzojnë shërbimin, tregon hulumtimi fundit i Agjencisë për komunikime elektronike (AKE). Në 12 muajt e fundit, 18 për qind e popullatës kanë shfrytëzuar roaming. Një pjesë e vogël e të anketuarve (17 për qind) që e dinë se çka është roamingu kanë dëgjuar për marrëveshjen për roaming dhe prej tyre 20,4 për qind e kanë shfrytëzuar. Shumica e shfrytëzuesve të roamingut rajonal (80 për qind) konsiderojnë se ai është dukshëm më i lirë. Më pak të njoftuar me roaming janë personat që kanë arsim fillor apo më të ulët (54,7 për qind nuk e dinë se çka është roamingu) dhe personat më të moshuar se 60 vite (54,6 për qind nuk e dinë çka është roamingu). Më shumë se gjysma e të anketuarve (69,3 për qind) që e dinë se çka është roamingu nuk e dinë se a kanë ofertë të mirë nga operatori i tyre. Sipas të dhënave të anketimit të AKE, në Maqedoni telefoni celularë shfrytëzohet 95,8 për qind e popullatës, nga të cilët 64,1 për qind shfrytëzojnë internet mobil, që është rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Ulet numri i nxënësve dhe studentëve nëpër konvikte

Shkup, 18 korrik - Në vitin akademik 2017/2018, numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve nëpër konvikte në arsimin fillor dhe të mesëm dhe në ato studentore arrin 6334, gjë që paraqet ulje për 6.2 për qind në raport me vitin 2016 - 2017, ka kumtuar sot Enti shtetëror për statistikë (ESH). Në konviktet e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm fetar janë të vendosur 247 nxënës. Në raportet vjetore janë përfshirë 37 konvikte: konviktet për nxënës në shkollat e fillore, për nxënës në shkollat e mesme, konvikte në shkollat e mesme fetare dhe konviktet studentore. Nga ESH-së bëjnë të ditur se konviktet për nxënës dhe studentë sigurojnë vendosje, ushqim dhe edukim të nxënësve dhe studentëve gjatë kohës së shkolimit jashtë vendit të jetesës së përhershme.

ADEMI NË BURGUN E OHRIT

Vërtetime për arsimim për 26 adoleshentë të dënuar

Ohër, 18 korrik - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi dhe koordinatoresha e përhershme e Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Republikën e Maqedonisë, Luiza Uinton dje ishin për vizitë të të burgosurit në Institutin për ndëshkim-përmirësim të personave të mitur që funksionon në kuadër të Burgut në Ohër. Ata 19 të burgosurve adoleshentë nga Institucioni ndëshkues-përmirësues

dhe të shtatë të burgosurve të rritur ua kanë dorëzuar vërtetimet për përfundimin me sukses të kurseve nga gjuha maqedonase dhe nga matematika në kuadër të arsimit fillor. Bëhet fjalë për projekt të cilin e realizojnë Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria për sanksione pranë Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim dhe me përkrahje të Zyrës së Programit për zhvillim pranë KB (UNDP) në Republikën e Maqedonisë. Mi-

nistri Ademi deklaroi se ky projekt për arsimim të të burgosurve adoleshent vetëm e vërteton premisën se secili meriton mundësi të dytë, posaçërisht kur bëhet fjalë për arsimim. "Si Ministri e Arsimit dhe Shkencës mbesim të përqendruar dhe do të japim kontribut konkret që të krijojmë arsimim cilësor dhe njëkohësisht arsimim për të gjithë. Programe të këtylla realizohen edhe në institucionet tjera, edhe në kuadër të arsimit fil-

lor, por edhe përgatitje profesionale", tha Ademi. Luiza Uinton theksoi se projekti për arsimim të të burgosurve adoleshent është në përputhje me moton e KB-së që askush të mos harrohet, gjegjësisht askush të mos lihet pas dore, duke shfaqur besim se programe të ngjashme do të vazhdojnë edhe më tutje për të gjithë personat e rinj të cilët janë në institucione për përmirësim që ta kompletojnë arsimimin. (mia)

Referendumi



Nga
Nazim RASHIDI

Maqedonia mbetet peng e mendësisë indiferente të politikës e cila ndonëse e shet si sukses të madh atë që është arritur, sërish nuk artikulon atë vizionarizëm për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë fuqinë e vendimit që mund të kenë.

E përmenda në një bisedë rastësisht e pastaj pak më vonë e lexova edhe te një shkrim i Mehmet Krajës thënien e Aristotelit, që e parafrazuar do thotë se është edhe më keq se diktatura, kur në formë demokratike në krye të pushtetit ka ardhur injoranca. Të përballur jemi prej kohësh me këtë realitet, ku nuk dimë si të artikulojmë as se si lehtësinë me të cilën pushtetet shkelin ligje dhe keqpërdorin shtetin dhe pastaj edhe me një super lehtësi justifikojnë veprimet, apo edhe më keq hiqen si struci, duke e futur kokën në zyrat e tyre e bëjnë sikur nuk shohin e dëgjojnë, ndërkohë që reagimet nuk shkaktojnë efektin e tyre. Nuk i sjellin para asnjë përgjegjësie dhe kështu rrënimi shoqëror vazhdon.

Të mbështjellë në betejën publike gjithçka tentohet të përballet me "PR" (Public Relation), apo me truqet në shqip me Marrëdhëniet me Publikun, ku specialistët e fushës tentojnë të theksojnë apo tërheqin vëmendjen sipas qëllimit që duan të arrijnë me mesazhet e dërguara në publik dhe kështu i gjithë fokusi mbetet tek perceptimet dhe as e si tek thelbi. Kur beteja publike bëhet se si me çdo kusht të ruhet vota, apo dhe të rrëmbehet votuesi nga kampi tjetër dhe kjo bëhet në formën më makiaveliste të mundshme, pa menduar asnjëherë pasojat, ndodh ajo që kemi sot: Një shoqëri të përcudnuar me vlera dhe përfaqësues në institucione që s'kanë vizion më të gjatë se interesi personal, duke mos e ditur të shkretët dhe mungesa e një vizionarizmi për shoqërinë të parët që do t'i hajë janë ata vetë.

E tillë është pamja jonë në sferën publike, ku dominohet nga politika e cila në shumë raste as që ka dimensionet e një perspektive thelbësore edhe kur ka momente tejet të rëndësishme për të ardhmen e njerëzve. Pa dashur të vë tone të peshave të mëdha, ku ky popull, fiks siç ka thënë Çerçilli, ka konsumuar aq shumë histori sa s'ka më kapacitete tretëse, politika as e si ta ndihmojë këtë proces me një vizionarizëm më largpamës se sa marrja e

pushtetit pas disa muajsh. Nën një tablo të tillë dhe me shume pikëpyetje se çfarë do ndodhë me Maqedoninë gjatë disa muajsh, forcat politike Maqedonase po shprehen tejet të ndara rreth referendumit për emrin, rreth marrëveshjes për Greqinë dhe vetë emrit të ri Republika Maqedonia e Veriut.

Por si shikohen gjithë këto pikëpyetje që dalin tek maqedonasit, nga shqiptarët? Ose, a janë bërë shpjegime të duhura se çdo të thotë e gjitha për shqiptarët dhe të tjerët nëse Maqedonia mbetet peng e mendësisë indiferente të politikës e cila ndonëse e shet si sukses të madh atë që është arritur, sërish nuk artikulon atë vizionarizëm për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë fuqinë e vendimit që mund të kenë. Kjo në një anë, në tjetrën, edhe pse kalon më pak nga shqiptarët, kemi gati thirrje për mossaues të referendumit dhe me këtë hapjes së paqartësive deri në qiell. Si duhet sjellë pra?

Do t'ju përshkruaj dy sekuenca bisedash, të rastësishme, që i bëra në një hark kohor tejet të shkurtër, por që i lidh i njëjti shqetësim dhe e njëjta mungesë informacioni për gjithë këto zhvillime. Dy personat,

janë njerëz të shkolluar, profesionist dhe që ndjekin me vëmendje të gjitha zhvillimet politike. Nuk kam pyetur qartë për simpatitë e tyre politike, por në bisedë mund të vëshre kritika dhe lëvdata në një sens më civil, për zhvillimet. I pari, një mërgimtar, gati me ngazëllim të pa parë dhe deri diku dhe ofendues, thoshte se s'kishte pse të votojë, nëse mërgata do të votonte, në referendumin për emrin.

Wowww, si ka mundësi një mendësi e tillë? Por pyetjet e tij ishin të qarta: "Çfarë fitojnë shqiptarët?" dhe komente të tipit "Maqedonia siç po ekziston tani do ekzistojë sërish edhe pa integrimet në NATO dhe BE". Dua të tërheq vëmendjen edhe një herë se nuk bëhet fjalë për person të painformuar, bëhet fjalë për një person tejet të edukuar që në mendimin tim as që duhej të kishte dilema të tilla.

Gjithsesi, pyetjet e ngritura kur vinë prej tij, tregojnë se si ai e shumë njerëz mbase ende se kanë të qartë se çfarë do të ndodhë, të jesh një vend i ngecur në vend, kur parimet për të cilat të gjithë mundohen të vijnë në funksion, nuk do të vinë, sepse të jesh i ngecur do të thotë aq lehtë tu bësh bisht standardeve për

Integrimi miq, nuk do të thotë vetëm lehtësi vizash e punësimesh jashtë, por përqaftim dhe pranim i një sërë vlerash dhe parimesh të cilat do sjellin jetë më të mirë, rend dhe qetësi për të gjithë ne. Por e gjitha fillon nga ne dhe prej nesh. Prandaj nëse politika është e çoroditur në baltën e vetë të interesave, flisni hapur dhe me zë vizionet tona



jetë më të mirë, për liri dhe sidomos për përgjegjësi për ata që kanë fatet e njerëzve në dorë. Po OK, thashë, duhet të përballemi me këto pyetje për deri sa përgjigjet e dhëna aq shpesh nuk kanë krijuar efektin e duhur, të kuptuarit e rëndësisë për të qenë pjesë e vlerave dhe jetës perëndimore. Siç thashë, thujase pak orë më vonë, por në një bisedë tjetër, një konstatim tjetër mu përplas në fytyrë.

"Nuk na duhen mërgimtarët të vendosin për fatin tonë", tha bashkëbiseduesja e ime, e cila gjithashtu është tejet e edukuar dhe njohëse e të gjitha proceseve politike. Para se të jap unë argumentin se "hejhhh, po pa mërgimtarët shumë realitete politike në Maqedoni as që do t'i kishim arrirë", ajo këtë e tha vetë. Po, e di, roli i tyre cili ka qenë. Por ideja e saj është, cili do jetë roli i tyre tani? Të ardhur nga shoqëri të rregulluar, me sisteme funksionale të përditshmërisë por edhe ligjore dhe shoqërore, patriotizmi i tyre sipas bashkëbisedueses time, nuk mjafton më vetëm duke valëvitur flamurin, apo vendosje e shqiptonës dy krenare në qafore, apo dhe si tatuazh meqë bëhet fjalë edhe për një brez mërgimtarësh më të rinj, por edhe

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 18 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

kryerja e presionit sipas saj, tek politika për përfaqimin dhe zbatimin e vlerave të shoqërive nga ata vinë dhe ku ne duam të shkojmë.

"Nuk shoh që ata (mërgimtarët) përpiqen të kërkojnë standarde të njëjta me vendet nga vinë", tha bashkëbiseduesja. Sipas saj kjo i bënte ata të mos e kuptojnë realitetin e jetës këtu dhe nevojën që kanë këta njerëz. Si rrjedhojë, ajo tha, "jo nuk dua të vendosin për fatin tim në votime, dhe pastaj të ikën e ne të na lënë në baltën e rezultateve". I gjithë ky dallim në opinione sjell për mua përfundimin se mungesa e të kuptuarit të rëndësisë së momentit po vjen nga mungesa e një shkëputjeje totale të politikës, politikanit nga njerëzit dhe mungesa e komunikimit të vizioneve. Në fakt degjenerimi i politikës në përfitime personale, tenderë dhe beteja bajate në rrjetet sociale, ka bërë njerëzit të çorodisur dhe veprimin e tyre politik. Sepse në fund të fundit çdo veprim i yni, apo dhe mos veprim i yni sjell një realitet politik të cilin pastaj ne duhet ta mbajmë në kurriz.

Mërgimtarin mezi e binda, se vota në referendum në fakt është për mua, për ne që jemi këtu. Sepse ky realitet i momentit ka sjellë pak shpresë, se gjërat edhe mund të venë në drejtimin e synuar me vite. Nuk ka se si një mërgimtar me lehtësi të hedhë poshtë të mirën time, dëshirën për një jetë më të mirë, sepse edhe unë edhe ne jemi dhe të tyrët. U bind (të paktën kështu dua të besoj). Kurse bashkëbisedueses tjetër i thashë, mërgimtarëve u duhet sqaruar konteksti. Di plotë që në rrethana të caktuara duan të vinë dhe të kontribuojnë në zhvillimin tonë, por çështja është se a i kanë ftuar?

E gjithë rilindja jonë kombëtare ka ardhur në këto troje nga mërgimtarët e kohës. Kjo mund të ripërsëritet në kontekstet e sotme me teknologjinë dhe dijen e kohës. Por, sërish, a ka pasur nisim të tilla? Sigurisht që bashkëbiseduesja pranoi këto argumente, por pavarësisht në të dyja rastet mbetet fakti i moskomunikimit në të gjitha nivelet të politikës dhe njerëzve, dhe më shumë akoma, mosprezantimi qartë i vizionit afatgjatë. Integrimi miq, nuk do të thotë vetëm lehtësi vizash e punësimesh jashtë, por përfaqim dhe pranim i një sërë vlerash dhe parimesh të cilat do sjellin jetë më të mirë, rend dhe qetësi për të gjithë ne. Por e gjitha fillon nga ne dhe prej nesh. Prandaj nëse politika është e çoroditur në baltën e vetë të interesave, flisni hapur dhe me zë vizionet tona.

(Autori është kolumnisti i rregullt i gazetës KOHA)

Kolinda puth për Kroacinë!



Emanuel Macron nuk kishte asnjë shans. E pushtuar nga emocionet mbas ndeshjes mbresëlënëse të ekipit kroat të futbollit, presidentja kroate Kolinda Grabar-Kitarovic përqafoi presidentin francez. Duke harruar distancën e figurave shtetërore. Ai, zotëri burrë, e lë të ndodhë. Më pas kjo do të përsëritet, poshtë në shesh, kur të dy do të përshëndesin ekipet e tyre, të bërë qull nga shiu. Por kjo nuk mbaron me kaq. E pushtuar prej ndjenjës së suksesit mbas ndeshjes së zemrës së kroatëve të saj, ajo përqafon dhe puth këdo që ndodhet afër saj. Të parin trajnerin, pastaj 22 lojtarët kroatë përfshirë dhe trajnerin dhe në fund madje gjithë ekipin francez të futbollit. Kur përshëndet lojtarin më të mirë të kampionatit, Luka Modricin asaj madje i dalin lotët.

MBRETËRESHË E PËRZEMËRSISË...

Brenda sekondës presidentja kroate u bë hit në mediat sociale, në të gjithë botën. Me bluzën e bardhë me të kuqe në vend të garderobës së përshtatshme me postin, ajo u kthye në yll të mediave. Presidentja kroate na mëson se njeriu duhet të jetë "i hapur dhe i thjeshtë", ose "emocional dhe i ngrohtë". Në twitter shtohet madje ky pohim: "Dy zbulimet më të mëdha të Kampionatit Botëror janë Kylian Mbappe dhe Kolinda Grabar-Kitarovic. Për shkak të këtyre golave dhe për shkak të këtyre përfaqimeve ky Kampionat Botëror u kthye në ngjarje inspiruese".

Madje mediat serbe, që janë kritike dhe refuzuese kur bëhet fjalë për Kroacinë, shkruajtën të çuditur që presidentja kroate ia vodhi shfaqjen të gjithëve në Moskë. Mediat gjermane lëshuan në twitter një citat: "Kur të rritem do marthohem me

presidenten kroate". Kaq gjëra pozitive për Kroacinë nuk janë thënë prej kohësh.

...APO VETËM E SIKLETSHME?

Sidoqoftë jo të gjithë janë të entuziazmuar me prezantimin e presidentes, madje edhe në Kroaci. Shumë vetë i pritën shpërthimet emocionale të saj me ndjenjën e turpit. Ajo nuk duhet të bëhet qesharake dhe të vërtetojë edhe një herë të gjitha klishetë për ballkanetë si pa shije dhe pa distancë. Sepse jo vetëm në ndeshjen finale, por edhe gjatë ndeshjeve kualifikuese të Kampionatit Botëror ra në sy Kolinda Grabar-Kitarovic me kërcimet e saj të gëzuara gjatë çdo goli të bërë prej kroatëve. Me tallje u fol për "Cheerleader-en me postin më të lartë". Të tjerët lëvduan me ironi mikpritësit rus "që e patën angazhuar atë si këngëtare, për të sjellë në qejf burrat që ndodheshin në lozhe". Një komentator kroat sporti tha mbas orgjisë së puthjeve në ceremoninë përfundimtare, sa keq që filloi të bjerë shi. Përndryshe presidentja do kishte shkuar të puthte sportistët që ndodheshin aty përreth.

TAKTIKË E ZGJUAR

Vallëzimi si akti ku puqen këci nacionalist dhe patriotizmi i shëndoshë, politika serioze dhe populizmi është karakteristikë për Kolinda Grabar-Kitarovic. Asaj i pëlqen të ndodhet mes njerëzve, të inskenojë veten si "presidente gju më gju me popullin", që kritikon punën e qeverisë që ndodhet larg popullit. Studiuësja e shkencave politike, që flet anglisht, spanjisht dhe gjermanisht dhe ka studiuar në disa vende evropiane dhe në SHBA, është që prej 2015 presidente e shtetit kroat. Para kësaj ajo ka qenë diplomate dhe zëvendës-sekretare e Përgjithshme e

Kroacia e humbi ndeshjen finale me Francën. Megjithatë njerëzit në Kroaci kanë një gjendje emocionale të një lloji të veçantë. Me në krye presidenten Kolinda Grabar-Kitarovic



NATO-s në sektorin e diplomacisë publike. Në Kroaci presidenti i shtetit zgjidhet në zgjedhje direkte, megjithatë zgjedhja e saj, në atë kohë politikane pak e njohur nga radhët e dyta të partisë kristiandemokrate HDZ, ishte fitore kundrejt socialdemokratit shumë popullor, mbajtës të postit, Ivo Josipovic. Që me zgjedhjen e saj Grabar-Kitarovic, mundohet të proflizohet si "nënë e kombit", sepse posti i presidentit në Kroaci nuk është vetëm me detyra riprezantuese. Bashkë me qeverinë ajo duhet të jetë pjesë e bërjes së politikës së jashtme, të drejtojë shërbimin sekret dhe të jetë shefe e shtabit të përgjithshëm të forcave të armatosura.

ZGJEDHJE TË TJERA SHPEJT

Kështu Grabar-Kitarovic përzihet edhe në politikën e përditshme dhe ajo i bie rregullisht kambanave nacionaliste. Ajo prezantohet si mbrojtëse e kroatëve në Bosnjë dhe Heregovinë dhe kërkon forcimin e postit të saj në shtetin jo stabil. Ajo takohet në Argjentinë me migrantë kroatë, që vajtojnë ende regjimin fashist të ustashevë dhe i lëvdon ata për dashurinë për atdheun. Ose thotë pa iu dredhur qerpiku se duhet krijuar një komision për të zbuluar të vërtetën mbi ish-kampin e përqendrimit në Jasenovc, duke injoruar faktin që biblioteka të tëra janë mbushur me libra për këtë temë dhe për 83 mijë viktimat e njohur me emra. E fryrë nga një klimë populiste Kolinda Grabar-Kitarovic e kupton rolin e saj si një forcë të tretë, të pavarur midis qeverisë dhe parlamentit. Vitin e ardhshëm do zhvillohen zgjedhjet presidenciale në Kroaci. Kolinda Grabar-Kitarovic nuk ka thënë ende nëse do të kandidojë apo jo. Edhe një legjislacion i lejohet të mbajë.

(DW)



A ju lë kafja pa gjumë?

Efektet e kafeinës në shkurtimin e periudhës së gjumit dhe përkeqësimin e cilësisë së tij janë të dokumentuara. Gjumi është një proces që ndikohet nga shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Kafeina është një prej këtyre faktorëve. Të dhënat shkencore thonë se sasia ditore e kafeinës ka një rol të rëndësishëm në sasinë dhe cilësinë e gjumit të natës dhe në përgjumjen e beftë gjatë ditës. Efektet e kafeinës në shkurtimin e periudhës së gjumit dhe përkeqësimin e cilësisë së tij janë të dokumentuara. Për më tepër, kafeina e prish gjumin duke e nxitur njeriun të zgjohet disa herë brenda natës. Ndikimi i kafeinës tek gjumi varet jo vetëm në sasinë e kafeinës që merret në mbrëmje por edhe në sasinë që është marrë gjatë ditës. Ndjeshmëria njerëzore ndaj kafeinës ndryshon në varësi të njeriut dhe faktorëve të tjerë siç është mosha.

Ushqimet që luftojnë kancerin



Kemi dëgjuar shpesh që brokoli dhe hudhra janë dy nga produktet më të mira dhe të shëndetshme që ne mund të konsumojmë kohë pas kohe. Por ka lajme edhe më të mira sesa kaq. Brokoli dhe hudhra mund të luftojnë kancerin. Studiuesit nga Universiteti Kopenhagen kanë zbuluar se seleniumi, një përbërës i gjendur tek brokoli dhe hudhrat ul shpejtësinë e zhvillimit të sëmundjeve të ndryshme kancerogjene, si tek femrat, po ashtu edhe tek meshkujt. Grupi i kërkuesve të këtij studimi është duke shpresuar që këto gjetje të mund të ndihmojnë në përmirësimin e trajtimeve për kancerin në një periudhë afatgjatë. Ky studim është publikuar në Journal Biological Chemistry. Sistemi imunitar është i predispozuar të largojë nga trupi gjëra që nuk i përkasin atij. Ky proces ndodh edhe me qelizat kancerogjene, edhe pse disa prej tyre kanë aftësinë të bllokojnë sistemin imunitar që të mos i identifikojë këto qeliza, duke u përhapur dhe zhvilluar në këtë mënyrë gjithmonë e më shumë.

VARËSIA NGA TELEFONAT NDIKON NË SJELLJET E KËQIJA TË FËMIJËVE

Sjellja e dobët te fëmijët ishte më shumë e lidhur me përdorimin e telefonave nga ana e nënave të tyre, shkencëtarët zbuluan në revistën Pediatric Research. Studimet e fundit vlerësojnë se prindërit përdorin TV, kompjuterë, tabletë dhe telefona të mençur 9 orë mesatarisht në ditë

Prindërit që kanë një varësi ndaj telefonave të tyre mobilë mund të fajësohen për sjelljen e këqija të fëmijëve tyre, tregojnë studimet.

Shkencëtarët kanë zbuluar një trend midis përdorimit të tepruar të pajisjeve nga nënat dhe baballarët dhe problemet e sjelljes në të rinjtë. Pothuajse 200 familje u përfshinë në studimin e 'technoferece' - ndërprerje në ndërveprimet ballë për ballë për shkak të



pajisjeve teknologjike. Technoferece në ushqim mund të dëmtojë fëmijët, pohojnë kërkuesit, duke i bërë ata të bëhen hiperaktivë, ose të zemëruar.

Sjellja e dobët te fëmijët ishte më shumë e lidhur me përdorimin e telefonave nga ana e nënave të tyre, shkencëtarët zbuluan në revistën Pediatric Research. Studimet e fundit vlerësojnë se prindërit përdorin TV, kompjuterë, tabletë dhe telefona të mençur 9 orë mesatarisht në ditë. Një e treta e kësaj

kohe llogaritet të shpenzohen për telefona të mençur, shpesh të përdorura gjatë aktiviteteve familjare, si p.sh. gjatë ngrënies dhe kohës së gjumit. Ekspertët e Universitetit Shtetëror të Illinois dhe Universitetit të Miçiganit thanë se të gjitha këto janë të përfshira në formësimin e mirëqenies social-emocionale të një fëmije. Brandon McDaniel, i cili udhëhoqi studimin, tha se prindërit që kanë fëmijë me probleme më të theksuara bëhen më tepër të stresuar. "Kjo mund të çojë

në tërheqjen e tyre më të madhe në teknologji, e cila mund të kontribuojë në problemet e fëmijëve", tha ai. Studimi vjen pasi Manchesteri është gati të nisë një fushatë për të trajtuar 'ndarjen' në komunikimin midis prindërve dhe fëmijëve si pasojë e përdorimit të teknologjisë. Qyteti do të bëhet autoriteti i parë në Britani të Madhe për të filluar një skemë të tillë, e cila do të udhëzojë prindërit për rastet kur duhet të mos përdorin telefonin e tyre.

Ilaç natyral për ta zvogëluar rrezikun e hipertensionit

Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar, shtypja e lartë e gjakut i prek më shumë se 25% të të gjithë banorëve të rritur. Kjo sëmundje, ndryshe e njohur si hipertensioni, e rritë edhe rrezikun e disa komplikimeve vdekjeprurëse, siç janë sulmet e zemrës dhe ato të trurit. Por, ndryshimi i mënyrës së ushqyerjes dhe stilit të jetës mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të zhvillimit të simptomave të hipertensionit. Për shembull, nutricionistja Dr. Sarah Brewer ka thënë se përdorimi



i suplementeve valeriane mund të ketë efekt në zvogëlimin e shtypjes së lartë të gjakut. "Valeriani është

një nga ilaçet më efektive natyrale për shtypje të lartë të gjakut. Rrënjët e valerianit janë përdorur si

qetësues qysh prej kohërave mesjetare për ta lehtësuar ankthin, për ta zvogëluar tensionin e muskujve dhe për ta përmirësuar kualitetin e gjumit", ka shkruar ajo. Ky ilaç bëmor funksionon duke i kundërshtuar efektet e stresit sepse vetitë qetësuese i bllokojnë enzimën e caktuar në tru, që më pas e lejon sasinë e acidit gama-aminobutirik të rritet. Vlen të ceket se valeriani mund të përdoret edhe për t'i zgjidhur problemet me gjumë, sulmet e panikut, etj.

Hirra është eliksir i vërtetë

Gjysmë litri deri në një litër e hirrë në ditë dhe pas disa ditësh do të shihni ndryshime të pabesueshme, thekson një studim. Hirra (në Kosovë përdoret emri kumshtë) është produkt, i cili krijohet gjatë prodhimit të djathit e kosit dhe në të mbeten përbërësit më të mirë dhe më të vlefshëm të qumështit: vitaminat B dhe E, mineralet dhe sheqernat e qumështit, të cilat janë të rëndësishme për ndërtimin e lidhjeve më të mira në tru.

Për të nxjerrë më të mirën nga kjo pije, ekspertët këshillojnë që të pini maksimalisht gjysmë litri në një litër hirrë në ditë. Këto janë të gjitha përparësitë e kësaj pijeje natyrale:

- Ndhmon në dobësim: 100 ml hirrë ka vetëm 26 kalori. Ajo përmban një sërë albuminash dhe për këtë arsye krijon ndjenjën e të ngopurit, ndërkaj është e varfër me yndyra dhe kalori.

- Ndhmon te konstipacioni: Hirra ka cilësi diruetike që do të thotë se do të nxisë shpejt tretjen dhe do të zgjidhë ndjenjën e pakëndshme të konstipacionit dhe fryrjes. Mos e teproni me këtë artikull, sepse mund të shkaktojë diarre. Deri në një litër është maksimalja.

- Ilaç për mëlçi: Kjo pije e varfër përmban beta-laktoglobulinë e cila furnizon organizmin me amino-thartirat BCAA, të cilat ndihmojnë



te sëmundjet e avancuara të mëlçisë, të sëmurëve nga të thatit u mundëson që të bëjnë jetë më gjatë dhe më cilësore.

- Ndërton muskujt: Hirra, posaçërisht ajo pluhur, ndihmon te ndërtimi i masës muskulore por edhe përmirëson muskujt pas lodhjes fizike.

- Rregullon yndyrën e tepërt në

gjak: Hirra u rekomandohet njerëzve të cilët kanë probleme me yndyrën e tepërt në gjak. Pas vetëm disa javëve të konsumimit të rregullt do të shihni efektet të mrekullueshme.

- Krijon lumturinë dhe zvogëlon lodhjen: Hirra nxit tajitje të serotoninës, hormoni lumturisë, dhe kështu zvogëlon ndjenjën e stresit.

AKTIVITETI I LEHTË FIZIK UL RREZIKUN E VDEKJES TEK MESHKUJT E MOSHUAR

Meshkujt e moshuar, të cilët marrin pjesë në ushtrime të moderuara e fizike, kanë një rrezik më të ulët të vdekjes, sipas hulumtuesve në Britani

Vetëm 150 minuta aktivitete javore e bëjnë një ndryshim tek meshkujt në mes të moshës 40 dhe 59-vjeçare, konkluduan hulumtuesit në katër spitale dhe universitete në një artikull të publikuar të hënën në British Journal of Sports Medicine. "Rezultatet sugjerojnë se të gjitha aktivitetet, sado modeste të jenë, janë të dobishme", shkruajnë hulumtuesit. "Zbulimi se aktiviteti fizik i intensitetit të ulët, i cili është i lidhur me rrezikun më të ulët të vdekshmërisë, është veçanërisht i rëndësishëm tek meshkujt e moshuar, pasi që shumica e aktiviteteve të tyre të përditshme fizik është me intensitet të lehtë.

"Për më tepër, modeli i akumulimit të aktivitetit fizik nuk i ndryshoi lidhjet me vdekshmërinë, duke sugjeruar se do të ishte e dobishme të inkurajoheshin

meshkujt e moshuar që të jenë aktivë pavarësisht periudhave të shkurtra". Udhëzimet e ushtrimeve aktuale sugjerojnë të paktën 150 minuta aktivitet të moderuar dhe të fuqishëm në periudhat që zgjasin 10 ose më shumë minuta. Hulumtuesit përcaktuan se kohëzgjatja nuk është e domosdoshme.

Për studimin, hulumtuesit i analizuan të dhënat nga 7,735 pjesëmarrës nga 24 qytete britanike të rekrutuar fillimisht nga viti 1978-80, të cilët ishin midis moshave 40 dhe 59 vjeç. Nga 2010-12, 3,137 të mbijetuar iu nënshtruan një ekzaminimi fizik dhe u pyetën për mënyrën e tyre të jetesës, modelet e gjumit dhe diagnozat e sëmundjeve të zemrës. Nga pjesëmarrësit fillestarë, 1,655 e bartën një akselerometer gjatë orëve të zgjimit për shtatë ditë,

dhe hulumtuesit pastaj e monitoruan shëndetin e tyre deri në qershor të vitit 2016 ose deri në vdekje, cilado që erdhi e para. Aktiviteti i lehtë përfshinte kopshtari të lehtë ose nxjerrjen e qenit për shëtitje.

Analiza përfundimtare u bazua në 1,181 meshkuj, me një moshë mesatare prej 78 vjeç, të cilët e bartën pajisjen gjatë gjithë kohës dhe nuk kishin sëmundje para-ekzistuese të zemrës. Gjatë pesë viteve, 194 prej meshkujve vdiqën. Në të dhënat çdo 30 minuta shtesë të ushtrimit të intensitetit të lehtë çoi në një reduktim prej 17 për qind në rrezikun e vdekjes. Mesatarisht, ulja e rrezikut të vdekjes ishte rreth 33 për qind. Me periudha të shkurtra sporadike të aktivitetit të moderuar dhe të fuqishëm, pati një rrezik 41 për qind më të ulët të

vdekjes. Dhe seancat që zgjasin 10 ose më shumë minuta kishte një rrezik më të ulët prej 42 për qind.

"Duke e pasur parasysh rënien e shpejtë të aktivitetit fizik me moshën në mesin e popullatave të moshuara, inkurajimi i aktiviteteve qoftë edhe më të moderuara apo lehta mund të ofrojë përfitime në jetëgjatësi", shkruajnë hulumtuesit. Hulumtuesit sugjeruan përdorimin e një mostre më të madhe dhe përfshirjen e femrave. Hulumtuesit gjithashtu thonë se gjetjet e studimit të tanishëm mund të përdoren për t'i rivlerësuar udhëzimet e aktivitetit fizik, duke i bërë ato më të arritshme për të rriturit e moshuar dhe për të bërë më shumë për t'i inkurajuar të rriturit e moshuar që të angazhohen në aktivitet.

Kastravec për të luftuar diabetin



Pacientët me diabet mund të ulin nivelet e sheqerit në gjak duke konsumuar kastravec, sugjeron organizata "Diabetes Council", e cila drejtohet nga ekspertët të diabetit. Kjo perime është e pasur në fibra, një lëndë ushqyese kjo që ndihmon në uljen e niveleve të sheqerit në gjak. Fibrat ngadalësojnë tretjen e karbohidrateve dhe sheqerit, duke ndihmuar kështu në uljen e niveleve të tyre. Kastravecët përmbajnë mesatarisht 10 kalori. Një studim i vitit 2010, i publikuar tek revista "Plant Foods for Human Nutrition" ka zbuluar që kastravec mund të ulë nivelet e sheqerit në gjak.

Pasoja e rënda të vapës së madhe

I nxehti ndikon negativisht në aftësitë mendore. Pra temperatura e larta kanë efekt jo vetëm te njerëzit e moshuar, por edhe mbi të rinjtë. Sipas universitetit Harvard, vapa ka impakt mbi organizmin edhe në aftësitë logjike, në arsyetim dhe kujtesë. Janë marrë në analizë dy grupe studentësh, njëri prej të cilëve mëson në temperaturat e stinës së nxehtë duke u freskuar vetëm me ventilator. Ndërsa grupi tjetër studioje në ambiente të freskëta me ajër të kondicionuar. Rezultatet e këtij grupi ishin shumë ndryshe nga ato të grupit të parë, duke shfaqur rendiment shumë më të lartë në studim. Sipas kërkuesve, temperatura ideale është 22 gradë Celsius, që njeriu të jetë në kapacitetin e plotë mendor, por edhe fizik. Sipas studimit, një tjetër faktor që mund të ndikojë në rezultat mund të jetë edhe ndotja akustike, pikërisht në rastin e dritareve të hapura, por edhe fiziologjike, që sjell cilësia jo e mirë e orëve të gjumit për shkak të vapës dhe mungesës së theksuar hidratimi.

Si të ruani qumështin e gjirit, udhëzime për sigurinë e foshnjës

Ushqyerja me gji është prioritet për mbarëvajtjen e shëndetit të çdo foshnje, dhe çdo nënë duhet ta ndjejë si detyrë dhe obligim thelbësor ndaj fëmijës së saj. Edhe nënat të cilat kanë një karrierë të rëndësishme apo janë të detyruara të punojnë, mundën ta realizojnë ushqyerjen e plotë me gji, duke shtrydhur gjinjat dhe duke e depozituar qumështin në kushtet e duhura. Në këtë mënyrë, fëmija merr themelet më të shëndosha për shëndetin e tij.

Rregullat e sigurisë se ruajtjes së qumështit të gjirit

Jashtë frigoriferit, në temperatura ambiente (18-25gradë C): jo më shumë se 3-4 orë, në enë të mbyllur; hidheni poshtë çka mbetet 1-2 orë pas ushqyerjes.

Në çantë termus, 15gradë C: deri në 24orë. Këshillohet të vendosen pllaka të ngrira në kontakt me enën e qumështit; çantat të mbahen mbyllur, të hapen vetëm kur nevojitet.

Në freskues (4gradë C): deri në 72 orë; Vendoseni në zonën më të ftohtë të frigoriferit freskues.

Në ngrirje (-20gradë C): deri në 6 muaj; depozitoheni në fund të



ngrirjes, për temperaturë sa më konstante.


Si të ruani qumështin e gjirit pasi e keni shkrire

Në temperaturë ambiente (18-25gradë C): 1-2 orë

Në freskues: 24 orë

Në ngrirje: mos e ngrini më.

Para se të lëshoni kondicionerin në veturë, duhet të dini këto dy gjëra



Vozitja gjatë verës në vetura pa klimë është e paimagjinueshme, por mbani në mend avantazhet dhe disavantazhet e saj. Para së gjithash, le të përsërisim atë që thonë ekspertët çdo verë - mos e lini që temperatura në veturë të jetë në mënyrë drastike më e ulët se ajo e jashtme, pasi dëmtimi veten. Gjashtë deri në tetë shkallë dallimi është shumë.

Gjithashtu, mos u mbështetni tepër në klimë. Nëse është një udhëtim më i shkurtër, ndërsa klima fillon të punojë me kapacitet të plotë, ju jeni tashmë në cak. Shikoni të gjeni parking nën hije, vendosni petë në xham që të mos hyjë brenda i nxehti i madh. Rreziku më i madh i vjen nga bakteret dhe merimangat. Pastrimi i klimës rekomandohet zakonisht çdo dy

vjet, edhe pse nuk do të gaboheni nëse e pastroni çdo sezon. Përndryshe, ju lini hapësirë për shumëzimin e baktereve, kërpudhave që do të përfundojnë në trupin tuaj. Mos e drejtoni klimën direkt në fytyrë, pasi rrisni rrezikun e dhimbjes së kokës, sinusit, syve dhe të ngjashme.

Megjithatë, klima nuk është e keqe, përkundrazi. Ajo na lehtë-

son funksionimin në nxehtësinë tropikale, dhe pas të gjitha, ajo gjithashtu mund të jetë e dobishme. Kondicionerët e pastër dhe të saktë ndihmojnë në reduktimin e intensitetit të simptomave te njerëzit që vuajnë nga alergjitë. Ekziston edhe mundësia e instalimit të filtrave të polenit në kondicionerë dhe në pajisjet e ventilimit të makinave.

KOSOVA I KA PLOTËSUAR KRITERET PËR LIBERALIZIM VIZASH



Madje, këtë hap, zyrtarë të KE-së po e quajnë si kapitull të ri në historinë e përbashkët evropiane. Komisioni Evropian me këtë rast i ka bërë thirrje Këshillit të Ministrave të BE-së dhe Parlamentin Evropian që të ndërmarrin hapat e duhur dhe të aprovojnë propozimin e tyre

Komisioni Evropian do të dalë me rekomandim pozitiv për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës. Këtë ia kanë konfirmuar "Kohës Ditore" burime brenda KE-së duke thënë se Kosova tashmë i ka plotësuar të gjitha kriteret që do të çonin drejt heqjes së regjimit të vizave për kosovarët. Madje, këtë hap, zyrtarë të KE-së po e quajnë si kapitull të ri në historinë e përbashkët evropiane. Komisioni Evropian me këtë rast i ka bërë thirrje Këshillit të Ministrave të BE-së dhe Parlamentin Evropian që të ndërmarrin hapat e duhur dhe të aprovojnë propozimin e tyre.

Ndërkaq, sot në orën 16:30, komisioneri Avramopoulos, bashkë me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, do të mbajnë konferencën për media ku do të jepet lajmi për plotësim të kriterëve për liberalizim të vizave. Kadri Veseli, kryeparlamentar i Kosovës, pas takimit të sotëm me Mogherinin, tha se rekomandimi për liberalizim vizash është hapi i parë drejt hyrjes në fuqi të vendimit.

E kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se Parlamenti Evropian, më 29 apo më 30 gusht do të mblidhet për të miratuar vendimin e KE-së, e më pas të

shkojë edhe tek Këshilli i Ministrave të BE-së që të kalojë edhe në nivel të ministrave të Rendit, ku tha se do të jetë pak më vështirë, "por jemi me shpresë të madhe që me sot po e përmbysim një temë shumë të rëndësishme për qytetarët e vendit – lëvizja e lirë".

Ndërkaq, zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se Kosova do ta marrë raportin pozitiv për liberalizimin e vizave nga Komisioni Evropian. Në rrjetin social Facebook, Pacolli ka shkruar se ky do të jetë hapi i parë drejt liberalizimit të vizave për qytetarët

e Kosovës. "Sot është ditë e madhe për Kosovën evropiane. Izolimit të padrejtë për qytetarëve po i vije fundi. Sot do të marrim raportin pozitiv për vizat si hap i parë drejt liberalizimit", ka shkruar Pacolli në Facebook.

Sipas liderëve kosovarë, rekomandimi pozitiv i Komisionit Evropian është hapi i parë që çon deri te vota për liberalizimin në Parlamentin Evropian dhe një miratim nga Këshilli i Ministrave. Nëse këto tri procedura përmbillen me sukses për Kosovën, atëherë pritjet janë që vendimi përfundimtar të merret diku në fund të këtij viti.



Serbia s'ka shanse në BE pa e zgjidhur çështjen e Kosovës

Presidenti francez, Emmanuel Macron, kërkon që çështja e Kosovës të zgjidhet para anëtarësimit të Serbisë në BE. Macron i tha presidentit serb, Aleksandar Vučić, gjatë takimit që dyshja e zhvilloi në Paris, se Serbia "nuk do të hyjë automatikisht" në Bashkimin Evropian më 2025, datë kjo e përmendur më parë si e mundshme për anëtarësim, pasi fillimisht duhet përmbushur disa parakushte.

"Nuk mendoj se duhet parë këtë datë si një kriter automatik", tha Macron gjatë konferencës së përbashkët për media me presidentin serb Vučić në Pallatin Elysee, raporton "LaLibre". "Nëse nuk bëhet asgjë në raport me ato që është dakorduar në agjendën e negociatave deri më 2025, Serbia nuk ka shanse për anëtarësim në BE", tha presidenti francez, transmeton Koha.net. "Nuk kemi të bëjmë këtu me plotësim të hapësirave me 'ticka' me një datë e të themi 'më 2025 do të hyjmë'", shtoi Macron. Nëntorin e vitit që lamë pas, presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, përmendi se anëtarësimi i Serbisë dhe i Malit të Zi mund të ndodhë më 2025. Presidenti serb, Aleksandar Vučić, pas takimit me homologun e tij francez, tha se Serbia nuk do të ketë perspektivë evropiane nëse problemi i Kosovës mbetet i ngrirë, raporton "N1". "Nëse konflikti i Kosovës mbetet i ngrirë, të jini të sigurt se nuk do të ketë perspektivë evropiane, të jini të sigurt se investimet do të bien", tha Vučić para reporterëve serbë në Paris pas takimit me presidentin francez Emmanuel Macron.

Ai tha se Serbia do ta ketë përkrahjen e Macronit në gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi për Kosovën, duke shtuar se shpreson që ta ketë të njëjtën edhe nga Kancelarja gjermane Angela Merkel. "Në atë rast, ka pak shpresë", tha ai.

Për Kosovën, të dyja palët të pakënaqura në mënyrë të barabartë

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, pas takimit që zhvilloi me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në prezencën e Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini, u përball me pyetjen e një gazetari se "a do të njihni pavarësinë e Kosovës". "Gjithmonë ndodhem para kësaj pyetjeje, me atë se cila do të jetë zgjidhja e kompromisit. Kosova pret që ta njohim pavarësinë e saj, dhe si kompromis nuk ofron asgjë, pret vetëm njohjen e pavarësisë së Kosovës. Por, në çështjen e kompromisit, të dyja palët duhet të humbin diçka, jo njëra të fitojë gjithçka e tjera asgjë. Nëse jemi të dyja palët barabar të pakënaqura, atëherë mund të themi se kemi arritur një zgjidhje të vërtetë kompromisi", theksoi Vučić para gazetarëve në Bruksel pas takimit me Thaçin, raporton Koha.net. Megjithatë, ai tha se zgjidhja nuk është afër.

Malazezët janë "agresivë", mund të nisin Luftën e Tretë Botërore



Presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë se malazezët janë të fuqishëm, dhe njerëz "shumë agresivë" duke treguar frikën e tij se anëtarësi i ri i NATO-s mund të dërgojë aleancën në luftë masive. Në një intervistë për televizionin Fox News të incizuar në Helsinki dhe të transmetuar më 17 korrik në Shtetet e Bashkuara, Trump është pyetur rreth Artikullit 5 të NATO-s, në të cilin thuhet se sulmi ndaj një anëtarësi të aleancës, është sulm edhe ndaj gjithë anëtarëve tjerë.

Kur është pyetur nga intervistuesi: "Pse duhet djali im të shkojë në Mal të Zi për ta mbrojtur atë vend nga sulmi?", Trump ka thënë: "E kuptoj çfarë dëshironi të thoni, unë kam bërë të njëjtën pyetje".

Ai ka thënë se Mali i Zi është "shtet i vogël me njerëz shumë të fuqishëm, ata janë njerëz të fuqishëm, njerëz agresivë. Ata mund të bëhen agresivë dhe përgëzime, ja ku kemi Luftën e Tretë Botërore".

Në samitin e NATO-s, të mbajtur javën e kaluar, Trump u ka bërë thirrje vendeve anëtarë të rrisin shpenzimet e tyre për mbrojtje. Mali i Zi është bërë anëtarësi i 29-të i NATO-s në qershor të vitit 2017, duke bërë një kthim historik drejt aleancës transatlantike në mesin e kundërshtimeve nga Rusia. Moska ka kundërshtuar vazhdimisht zgjerimin e NATO-s dhe ka kritikuar ashpër Podgoricën për anëtarësim në aleancë.

BILANCI I GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË TURQI

Dy vjet zgjati gjendja e jashtëzakonshme në Turqi. Pas përpjekjes për puç në korrik 2016, presidenti Erdogan ka goditur ashpër. Tani hiqet gjendja e jashtëzakonshme. A do bëhet gjithçka më mirë? Bilanci është ky...



Mbas përpjekjeve për puç më 15 korrik 2016 qeveria turke deklaroi se përgjegjës janë anëtarë të Lëvizjes Gülen, që ndodhen në radhët e ushtrisë. Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan e quajti organizatë terroriste Lëvizjen Gülen dhe vendosi gjendjen e jashtëzakonshme për tre muaj, në mënyrë që të luftonte në mënyrë aktive kundër saj. Për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme qeveria mori të drejtën të reagonte pa dekrete. Kështu në institucionet shtetërore u vendosën rregulla të reja. Për shkak të shkarkimeve masive nga puna në shërbimet publike dhe arrestimet e shumta, opozita e quajti gjendjen e jashtëzakonshme si "puç civil dhe persekutim kundër kritikëve të qeverisë" dhe kërkoi heqjen e menjëhershme të gjendjes së jashtëzakonshme, por pa sukses. Gjendja e jashtëzakonshme u shty shtatë herë gjithsej.

SA VETË JANË ARRESTUAR?

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme u lëshuan gjithsej 32 dekrete. Sipas të dhënave zyrtare në pyetje u morën 160 mijë vetë dhe më shumë se 70 mijë vetë u arrestuan, mes tyre edhe gaze-

tarë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe politikanë të opozitës. Kundër 155 mijë vetëve u zhvilluan hetime për "anëtarësim në një organizatë terroriste". Me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme koha e mbajtjes në arrest u zgjat në 30 ditë. Kjo praktikë u përdor deri në fund të 2016. Vetëm pas një paralajmërimi nga Këshilli i Evropës, në fillim të vitit 2017, koha e mbajtjes në arrest u zvogëluar në 14 ditë.

SA VETË U SHKARKUAN NGA PUNA?

Gjatë dy vjetëve që zgjati gjendja e jashtëzakonshme u shkarkuan nga puna në shërbimin publik 121 131 vetë. Rreth 7 mijë vetë u shkarkuan nga universitetet, 5700 prej tyre nga forcat akademike. Po ashtu u mbyllën shkolla dhe qendra arsimore, për të cilat dyshohej se kishin lidhje me lëvizjen Gülen. Të drejtat e zgjeruara nuk u përdorën vetëm kundër idhtarëve të Lëvizjes Gülen, por u përdorën edhe kundër forcave opozitare. Kështu për shembull në territoret kurde rreth 100 kryetarë bashkish u zëvendësuan nga administratorë të detyrueshëm dhe shumë politikanë

kurdë u arrestuan. Organizata ndërkombëtare si OKB ose Këshilli i Evropës kanë kritikuar qeverinë turke për këtë dhe kanë folur për një "zhvillim alarmant".

SI KA QENË PUNA ME LIRINË E SHTYPIPIT?

Me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme u mbyllën 70 gazeta dhe 20 revista si dhe 34 stacione radioje, po ashtu si 30 shtëpi botimi dhe 33 stacione televizive. Hetimet kundër përfaqësuesve të mediave dhe arrestimet e gazetarëve për "propagandë në ndihmë të terrorizmit" ose "ofendimin e presidentit të shtetit" janë parë nga organizatat si në Turqi ashtu edhe jashtë saj. Sipas të dhënave të sindikatës së gazetarëve në Turqi ndodhen 143 gazetarë në burg.

Organizata "Reporterët pa kufi" ka tërhequr vëmendjen se me masat represive gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, shtypi u bë gjithnjë e më shumë njësoj.

Në vitin 2010 Turqia ndodhej në vendin 138 në vlerësimin ndërkombëtar të vendeve për lirinë e shtypit. Ndërkohë Turqia ka përfunduar në vendin e 157.

ÇFARË NDODH PAS HEQJES SË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME?

Gjendja e jashtëzakonshme hiqet, por presidenti Erdogan do vazhdojë të qeverisë me dekrete. Sepse në sistemin e ri presidencial ai ka të drejtën që të rregullojë me dekrete presidenciale disa fusha. Siç është bërë deri tani me dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme, edhe dekretet presidenciale kanë të drejtën si një ligj dhe madje me efekt të menjëhershëm. Përveç kësaj qeveria ka ashpërsuar ligjin kundër terrorizmit. Projektligji për ligjin e ri parashikon që guvernatorët të kenë të drejtë të kufizojnë hyrjen dhe daljen në qytete për 15 ditë dhe po ashtu të drejtën që të ndalojnë grumbullimet.

Për grumbullimet dhe protestat ligji parashikon që "ato nuk duhet të vështirësojnë jetën e përditshme." Edhe për të dyshuarit për terrorizëm ekzistojnë rregulla të reja. Pasaportat e personave kundër të cilëve zhvillohen hetime për terrorizëm mund të konfiskohen për tre vjet. Ligjet e reja kritikohen sepse faktikisht ato vendosin një lloj gjendje të jashtëzakonshme. (DW)



GRU-ja ruse, më e frikshme se KGB-ja

Janë të paktë ata që nuk kanë dëgjuar për KGB-në ruse, e cila bashkë me CIA-an amerikane mbizotëruan Luftën e Ftohtë. Por për GRU, akronimet e së cilës përkthehen Drejtoria Kryesore e Inteligjencës, nuk kanë dëgjuar shumë persona. Është pikërisht kjo agjenci ushtarake spiunazhi, e cila akuzohet se ka ndikuar në zgjedhjet presidenciale amerikane të 2016-s, ku Donald Trump u shpall fitues. Një ndikim ky që nga KGB-ja vështirë se mendohej të arrihej. Gjithashtu, po kjo agjenci spiunazhi akuzohet se fshihet pas vrasjes të ish-spiunit rus Sergei Skripal, një ish-kolonel i kësaj njësie, në Angli në muajin mars.

Vapë vdekjeprurëse në Japoni, temperaturat afër 40 gradë

Shërbimi Meteorologjik i Japonisë paralajmëroi se Japonia është përfshirë nga një valë e nxehtë e rrezikshme, me temperatura afër 40 gradë. Siç lajmëroi agjencia e lajmeve DPA, për shkak të vapës deri tani kanë vdekur të paktën gjashtë persona, ndërsa qindra kanë kërkuar ndihmë. Në mesin e të vdekurve është edhe një fëmijë gjashtëvjeçar, i cili është alivanosur në një ekskursion. Temperatura në Tokio dje ka arritur 35 gradë, ndërsa në qytetin e afërt Kumagaja deri 39 gradë. Temperaturat e larta kanë shkaktuar 12 rastet të vdekjes gjatë javës së kaluar, ndërsa afër 10.000 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Vala e nxehtë vjen pas përmbytjeve në pjesët perëndimore të Japonisë, ku kanë humbur jetën 220 persona.

EMIGRANTËT E MBYTUR: Italia po merr me qira vrasës nga Libia!

"Proactiva Open Arms" publikon një foto shkatërruese të dy trupave dhe akuzon Romën: "Lëreni të vdisni nga Libianët të cilët janë punësuar nga qeveria italiane". Libia ka lejuar dy gra dhe një fëmijë të vdesin në bordin e një varke që po mbytej. Ankesa vjen nga "Proactiva Open Arms" që publikon edhe fotografite e dy trupave në det, midis mbetjeve të

një varke. Në bordin e anijes OJQ që zbuloi trupat ishte edhe deputeti i LEU, Erasmo Palazzotto, i cili shkroi: "Matteo Salvini, të paktën sot ki mirësjelljen dhe respektin për të heshtur dhe për të hapur portet". "Rojat bregdetare libiane tha se kishin zbuluar një anije me 158 njerëz, të cilëve ju ofroi ndihmë mjekësore dhe humanitare", - shkroi theme-

luesi i OJQ-së, Oskarin Camps - "por ata nuk kanë thënë se lanë dy gra dhe një fëmijë në bordin e anijes së mbytur, sepse ata nuk donin t'i merrnin në anijen e patrullimit". "Kur arritëm", - thotë Camps - "gjetëm një nga gratë ende të gjallë, por për fat të keq nuk mund të bënim asgjë për gruan dhe fëmijën tjetër".



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave**

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë me herët nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 04/18 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 130/18), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon:

SHPLLJE PUBLIKE nr. 04/18

Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektar

I. LËNDË E SHPLLJES PUBLIKE

Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **996 ha 02 ar 40 m²** edhe atë për rajonet në vijim në Republikën e Maqedonisë:

Nr. rend	Rajoni	Sipërfaqja		
		Ha	Ar	m ²
1	Berovë	166	72	28
2	Vallandovë	84	36	62
3	Veles	41	82	11
4	Gostivar	12	57	86
5	Gjevgjeli	17	09	39
6	Dibër	109	94	30
7	Dellçevë	205	00	70
8	Kavadar	3	26	85
9	Kumanovë	78	68	93
10	Kratovë	2	83	61
11	Probishtip	35	84	99
12	Sveti Nikole	193	59	20
13	Strumicë	3	46	09
14	Shtip	40	79	47
GJITHSEJ		996	02	40

Të dhënat për tokën bujqësore nga kjo shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përbajtura në listën pronësore) janë në pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilin sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësinë periferike të Ministrisë ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.

Toka bujqësore në pronësi të shtetit e cila jepet me qira me këtë shpallje publike është me qëllim të kultivimit të kulturave bujqësore për prodhim të ushqimit për kafshë (drithra, furazhe dhe kultura industriale) për periudhë prej 15 vjet.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPLLJEN PUBLIKE

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.

Subjektet fizike duhet të jenë realitete të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.

Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.

Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimtaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore tu jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.

Personat e lidhur kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike dhe mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për pjesëmarrje.

Të drejtë pjesëmarrjeje në shpalljen publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektarë kanë personat të cilat nuk kanë të lidhur asnjë marrëveshje ekzistuese me Ministrinë.

III. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PJESËMARRJE NË SHPLLJEN PUBLIKE

Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira të hapësirave deri në 3 hektarë duhet të dorëzojnë:

a) për subjektet juridike:

- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);

- dëshmi (akt) të dhënës nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit në regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik;

- dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;

- dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë;

- dëshmi për pronësinë e numrit të frymëve të kafshëve (vërtetim nga shoqëria e autorizuar veterinarë ose ofertuesi në momentin e parashtrimit të ofertës ka në pronësi numër të frymëve të kafshëve);

- vërtetim nga Njësia periferike e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;

- deklaratë të dhënës me gjithë përgjegjësinë materiale dhe penale se oferta bëhet e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe që është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për tokë bujqësore, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave juridik, persona të lidhur fizik, person fizik i lidhur me person juridik ose indirekt persona të lidhur në subjekt juridik;

- deklaratë të vërtetuar në noter për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në fletëparaqitjen për pjesëmarrje;

- biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin e të punësuarve, aspektet e tregut, prishshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të nënshkruhet në secilin faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose nga personi i autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizuar të vërtetuar në noter);

- deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përmbyshur obligimet nga ajo marrëveshje.

b) për personat fizik:

- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);

- dëshmi se janë paguar obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontributeve në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim të detyrueshëm social;

- dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë.

- dëshmi për pronësinë e numrit të frymëve të kafshëve (vërtetim nga shoqëria e autorizuar veterinarë ose ofertuesi në momentin e parashtrimit të ofertës ka në pronësi numër të frymëve të kafshëve);

- fotokopje të letërnjoftimit;

- vërtetim për regjistrim në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore, vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga regjistri qendror për regjistrim si tregtar i vetëm;

- program për shfrytëzimin e tokës e cila përmban të dhëna bazë për familjen, pajisjen tekniko-teknologjike, qëllimi për të cilin shfrytëzohet toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilin faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);

- deklaratë për besueshmëri të të dhënave të paraqitura me fletëparaqitjen e vërtetuar në noter;

- vërtetim nga Njësia rajonale e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;

- deklaratë të dhënës me gjithë përgjegjësi materiale dhe penale se oferta paraqitet si e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe e cila është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për tokë bujqësore, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave të lidhur juridik, personave të lidhur fizik, person fizik me person juridik ose indirekt persona të lidhur në person juridik dhe

- deklaratë të vërtetuar në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës në personin juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe e cila nuk i ka plotësuar detyrimet nga ajo marrëveshje.

Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.

Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të plotësohet tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme, në të kundërtin oferta **nuk do të merret parasysh**.

Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se:

- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;

- janë dorëzuar pas afatit të caktuar për tu dorëzuar;

- që nuk kanë lidhur marrëveshje për qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit

- janë të dorëzuara në zarf të shënuar me të cilin do të mundëj të identifikohet ofertuesi;

- janë të parashtruara nga personi që nuk ka të drejtë të parashtrorë oferta dhe

- nuk janë hartuar sipas kushteve të caktuara në thirrjen publike **komisioni i hedhë si të pakompletuara**.

Ofertat për tokën bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën me detyrë administrative Komisioni do të vërtetojë se ka ndodhur ndryshim me pronësinë dhe madhësinë e gjendjes së fondit të kafshëve nga dita e dhënies së dokumentit të pronësisë së kafshëve deri në ditën e parashtrimit të aplikacionit, nuk janë regjistruar në AHV në pajtim me rregullat ligjore ose ekzistojnë pengesa të tjera me të drejta të padefinuara të fondit të kafshëve, Komisioni do të hedhë si të palëshuara.

Oferta e cila do të dorëzohet me qira më të ulët të ofruar se qiraja minimale e përcaktuar në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë si të palëshuar.

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit të lidhje me thirrjen publike **nuk do të shqyrtohen**.

Kushtet e parapara në biznes planin (për personat juridik), respektivisht aspektet e tregut (te personat fizik) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime kontraktuale të cilat obligohet ti përmbush në vëllimin, afatet dhe mënyrën se si do të jenë të përshkruara në shpalljen publike.

Secili ofertues mund të parashtrorë vetëm një ofertë origjinale për pjesëmarrje në shpalljen publike me dokumentacionin 3e nevojshëm nga pjesa III e kësaj shpallje publike

IV. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM

Komisioni realizon zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm në pajtim me rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund jepet me qira dhe përcaktimin e madhësisë së sipërfaqes të tokës bujqësore që mund të jepet me qira ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 12/08, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15, 129/15 dhe 27/16).

Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën mund të parashtrorë fletëparaqitja dhe e cila mund të jepet me qira një pjesëmarrësi, përcaktohet në bazë të pajisjes minimale materialo-teknike të ofertuesit dhe numrit të të punësuarve të planifikuar gjegjësisht të punësuar sipas programit gjegjësisht numrit të frymëve të kafshëve në pronësi të ofertuesit.

Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën mund të parashtrorë fletëparaqitje dhe e cila mund t'i jepet me qira një pjesëmarrësi, përcaktohet në bazë të pajisjes minimale materialo-teknike të ofertuesit dhe numrit të të punësuarve të planifikuar gjegjësisht të punësuar sipas programit gjegjësisht numrit të frymëve të kafshëve në pronësi të ofertuesit.

Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për të cilën mund të parashtrorë fletëparaqitje dhe e cila mund t'i jepet me qira një pjesëmarrësi, përcaktohet në bazë të pajisjes minimale materialo-teknike të ofertuesit dhe numrit të të punësuarve të planifikuar gjegjësisht të punësuar sipas programit gjegjësisht numrit të frymëve të kafshëve në pronësi të ofertuesit.

- për sipërfaqe deri në 50 ha – së paku 1 traktor të kategorisë së lehtë (deri në 80kv) dhe së paku një të punësuar të planifikuar në marrëdhënie të rregullt pune;

Madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund të jepet me qira një pjesëmarrësi në procedurë përmes shpalljes publike për kultivim të kulturave bujqësore për prodhim të ushqimit për kafshë (drithëra, furazhe dhe kultura industriale) përcaktohet në bazë të numrit të frymëve të kafshëve (lopë, thundror, dhen, dhi, derra dhe shpend) me të cilat posedon ofertuesi edhe atë:

-për një lopë ose një thundror, gjegjësisht 10 dhen ose dhi, gjegjësisht 4 derra, gjegjësisht 100 pula, gjela deti, shota, pata ose pula afrikane ndahet sipërfaqe prej 0,6 hektarë.

Sipërfaqja maksimale e tojës bujqësore në pronësi të shtetit që mund t'i jepet me qira një pjesëmarrësi është 3 hektarë nëse ofertuesi parashtron vërtetim për posedim të së paku 5 frymëve të lopëve ose thundrorëve, gjegjësisht 50 dhen ose dhi, gjegjësisht 20 derra gjegjësisht 500 pula, gjela deti, shota, pata ose pula afrikane.

Ofertuesi i zgjedhur më i volitshëm është personi pjesëmarrës i cili ka përmbushur kriteret nga Rregullorja për kriteret më të përafërta për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund të jepet me qira dhe përcaktimin e madhësisë së sipërfaqes së tokës bujqësore që mund të jepet me qira ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/06, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15, 129/15 dhe 27/16).

Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm gjatë procedurës së realizuar për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, bëhet në bazë të qirasë më të lartë të ofruar vjetore për hektar. Në rast kur është ofruar qiraja e barabartë vjetore për hektar, përparësi merr oferta e ofertuesit e cila në program përmban numrin më të madh të punësimeve të planifikuara gjegjësisht të punësuar në bazë të sipërfaqes së kërkuar.

Me përjashtim kur lëndë e dhënies me qira është toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe maksimale më të vogël se 3 hektarë, që mund ta marrë një ofertues sipas shpalljes publike lidhje me parcelat e ofruara katastrale, bëhet zgjedhje e ofertuesit më të volitshëm në bazë të:

- largësia nga vendbanimi, respektivisht qëndrimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike– 65 pikë;

- qiramarrja e ofruar vjetore për hektar– 25 pikë;

- statusi juridik i ofertuesit– 10 pikë.

Kriteri largësi nga vendi i jetesës, respektivisht vendbanimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike do të thotë se largësia nga vendi i jetesës, respektivisht selia e ofertuesit në raport me parcelën kadastrale që shpallet ndodhet në komunë të njëjtë kadastrale.

Kriteri qiramarrja e ofruar vjetore për hektar vlerësohet në bazë të formulës– qiramarrja e ofruar vjetore për hektar e ndarë me qiramarrjen më të madhe vjetore për hektar, të shumëzuar me numër maksimal të pikëve që mund të fitohen në bazë të këtij kriteri ku:

$S = (P/P_{maks}) \times 25$

S – numri i pikëve

P – qiraja e ofruar

Pmaks – qiraja më e lartë e ofruar

Kriteri statusi juridik i ofertuesit fitohet me numër maksimal të pikëve për ofertues që është kryerës i regjistruar i veprimtarisë bujqësore ose i siguruar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor si bujk individual, tregtar individual ose subjekte juridike që përmbushin kushtet nga neni 24 i Ligjit për tokë bujqësore.

Sipërfaqja maksimale për të cilën mund të aplikojë një ofertues nuk mund të jetë më e madhe se 3 hektarë, as më e vogël madhësia e një parcele katastrale gjegjësisht blloku.

V. ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës.

Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike për sipërfaqe deri në 3 hektar përcaktohet varësisht nga klasa katastrale dhe vendndodhja e tokës edhe atë: - - 25 euro në kundërvlerë denar për tokën bujqësore të klasës katastrale prej I deri në IV dhe

- 15 euro në kundërvlerë denarë për tokën bujqësore të klasës katastrale prej V deri në VIII, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës dhe

- nëse toka bujqësore gjendet në rajonin malor, çmimi fillestar i tokës së klasës katastrale prej I deri në IV do të jetë 15 euro, ndërsa për tokën prej klasës V deri në VIII do të jetë 5 euro në kundërvlerë denarë, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi geografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë geografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

Duke patur parasysh se lëndë e shpalljes publike paraqet parcela katastrale ose bllok me kufij natyror të formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale çmimi fillestar përllogaritet dhe shfaqet në pasqyrat tabelore për secilin rajon veç e veç për tokën bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.

VI. DORËZIMI I OFERTËS

Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm parashtror në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e epërme të majtë duhet të shënojë "mos hap" "Ofertë në sipas Shpalljes publike 04/18 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqe deri në 3 hektarë sipas rajonit (shënohet rajoni) dhe në mes "Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup" në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetata durore.

Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që do të mund të identifikojë ofertuesin, gjegjësisht dërguesin.

Ofertat e parashtruara në lidhje me këtë shpallje publike nr. 04/18 do të hapen publikisht në ditën e tretë të punës duke konsideruar nga dita e fundit për parashtrim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.

Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të takimeve në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti" nr. 2 Shkup me fillim në ora 10.

VIII. INFORMATA PLOTËSUESE

Për informata plotësuese ofertuesit mund të kontaktojnë në Ministrinë e Bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në njësitë rajonale, të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk ose në Sektorin për regjistrim dhe menaxhim me tokë bujqësore në telefonin: 02 313 44 77.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 111/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Mavrovës dhe Rostushës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për punë të përgjithshme 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 28.303,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. INS0101V01001 Këshilltar - Inspektor i autorizuar për tatime lokale dhe taksa komunale, 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 112/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Delçevës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101G01000 Referent i pavarur për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe manifestimeve, Njësia për zhvillim ekonomik lokal, parandalim dhe menaxhim me gjendje kritike, mbrojtje dhe shpëtim, Sektori për urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor, veprimtari komunale, komunikacion dhe ZHEL 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm gjimnaz
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 18.200,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016 dhe 64/2018), dhe në pajtim me Vendimin për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e Drejtorit të NP “Parking u i qytetit” – Shkup nr. 08 -6390/1 të datës 17.07.2018, Kryetari i Qytetit të Shkupit, shpall:

KONKURS PUBLIK për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike “Parking u i qytetit” – Shkup

1. Kandidatët për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë nënshtruar të Republikës së Maqedonisë;
- të posedojnë së paku 240 kredi sipas EKTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
- në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të posedojnë së paku pesë vite të përvojës së punës;
- të posedojnë një nga certifikatat e pranuara ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, me sa vijon: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).

VËREJTJE: Nëse kandidati nuk e përmbush kushtin e paraparë në pikën 1 alineja 5 të këtij konkursi në lidhje me njohjen e gjuhës angleze, ai është i obliguar që këtë kusht ta përmbush në afatin prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërtën atij do të pushohet mandati (në pajtim me nenin 13 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike – Gazeta zyrtare e RM-së nr. 64/2018).

2. Kandidatët për drejtor, përkaj dëshmime për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentet vijuese:

- fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
- propozim programin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes.
- 3. Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët janë të detyruar që ta dorëzojnë në original ose kopje të verifikuar te noteri.
- 4. Afati i parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë nga dita e shpalljes së konkursit publik në shtypin ditor.
- 5. Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te arkivi i Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 – me shenjë Kryetari i Qytetit të Shkupit – Për konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit të NP “Parking u i qytetit” – Shkup.
- 6. Drejtori zgjidhet me mandatin prej 4 viteve.
- 7. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Qyteti i Shkupit
Kryetari i Qytetit të Shkupit
Petre Shilegov



Policia tronditet nga ajo që gjen brenda kutisë

Dy binjakë tre vjeçarë janë gjetur të mbyllur brenda një kafazi të vogël prej druri nga policia në juglindje të Brazilit. Kur u pyetën nga autoritetet, prindërit e fëmijëve thanë se kishin mbyllur djemtë e tyre në arkë në mënyrë që të mund të merrshin me punët e tyre në bujqësi pa u penguar. Policia në qytetin Aparecidinha në shtetin Espirito Santo bëri zbulimin tronditës pasi një person anonim raportoi se prindërit i mbanin fëmijët vazhdimisht në kutinë prej druri. Mamaja e tyre 37 vjeç dhe babai 40, janë arrestuar pasi akuzohen për keqtrajtim ndaj të miturve, ndërsa djemtë janë nën kujdesin e shërbimeve sociale lokale. Binjakët nuk treguan ndonjë shenjë të të qenit viktimë të abuzimit fizik, tha policia.

Shijoni BOOZA-n, akullorja që nuk shkrin kurrë

Le t'i themi lamtumirë akullores tradicionale. Moda e re, e nisur në Nju Jork, quhet Booza. Është një akullore e pazakontë, e gërryer dhe rezistente ndaj nxehtësisë. Kjo risi e çuditshme e pasticerisë vjen direkt nga dyqani "Republika e Booza" në Brooklyn, por krijohet falë një recete të lashtë, që prejardhjen e ka në Lindjen e Mesme dhe që ka lindur rreth pesëqind vjet më parë. Dy përbërësit që e bëjnë produktin unik janë salepi dhe rrëshira e çamçakëzit, e kultivuar vetëm në ishullin grek të Kios. E dyta i jep akullit një ngjeshje të pazakontë. Gjithashtu ka shije të ndryshme, si karamelle i kripur, çokolatë e bardhë Sichuan me piper etj... Akullorja këputet si mozzarella dhe gjithashtu mund të shijohet duke e rrotulluar rreth lugës. Ajo sfidon temperaturat më të ngrohta dhe nuk shkrihet, duke u kthyer në "domosdoshmërinë" e kësaj vere.



Ekspertët përlogaritën se rreth 93 milionë persona nëpër botë janë të "pambrojtur" nga pickimi i gjarprit. Kjo do të thotë se këta persona ndajnë të njëjtin habitat, me 1 ose më shumë gjarpërinj vdekjeprurës për të cilin nuk ekziston një antihelm, jetojnë 3 ose më shumë orë larg qendrave urbane dhe shërbimi shëndetësor klasifikohet i cilësisë së dobët

Rreth 93 milionë njerëz janë në rrezik nga vdekja si pasojë e pickimit nga gjarpërinjtë, sepse nuk kanë akses nga antihelmi apo nga qendra të mira mjekësore. Të dhënat vijnë nga një studim i ri, i përcjellë nga britanikja The Telegraph. Sipas kësaj të fundit, gjarpërinjtë vrasin rreth 138 mijë persona çdo vit dhe lenë me dëmtim të përhershme rreth 400 mijë persona. Pjesa më e madhe e viktimave jetojnë në zona rurale në jug të Azisë dhe në zonat sub-sahariane në Afrikë dhe më të rrezikuarit janë të moshës 10 deri në 30 vjeç. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e klasifikon kafshimin nga gjarpërinjtë si një 'sëmundje neglizhence tropikale' dhe vijon përpjekjet për të bërë të mundur që trajtimet efektive të jenë të prekshme nga të gjithë. Një stu-

EKSPERTËT JAPIN ALARMIN

93 MILIONË NJERËZ TË RREZIKUAR NGA GJARPËRINJTË!



dim i ri i publikuar në Lancet përdori teknika për të zbuluar sa akses kishin njerëzit ndaj trajtimit, sa mundësi kishin për të marrë antihelm dhe sa afër jeton popullata me gjarpërinjtë më vdekjeprurës në botë.

Nga 278 lloje gjarpërinjsh vdekjeprurës, për 119 prej tyre nuk ka një antihelm specifik. Prej këtyre specieve, 24 janë të klasifikuar si të "kategorisë së parë" nga OBSH, pasi konsiderohen si më të përhapurit dhe më vdekjeprurësit. 95

klasifikohen në kategori të dytë, që do të thotë se janë specie më pak të zakonshme dhe më pak vdekjeprurëse. Ekspertët përlogaritën se rreth 93 milionë persona nëpër botë janë të "pambrojtur" nga pickimi i gjarprit. Kjo do të thotë se këta persona ndajnë të njëjtin habitat, me 1 ose më shumë gjarpërinj vdekjeprurës për të cilin nuk ekziston një antihelm, jetojnë 3 ose më shumë orë larg qendrave urbane dhe shërbimi shëndetësor klasifikohet i cilësisë së dobët.

Nëse merrnin në konsideratë të gjithë këto faktorë, ekspertët zbuluan se ata që jetonin në pjesë të vendeve si Benin, Kongo, Etiopi, Mianmar, Nigeri, Sudani Jugor dhe Papa Guinea e Re kanë më shumë gjasë që të vdesin ose të kenë pasojë të rënda pas pickimit nga gjarpri. Për shembull, në Papa Guinea e Re, më shumë se 600 mijë persona jetojnë në afërsi me gjarpërinjtë e kategorisë së parë dhe janë më shumë se një orë larg nga një qendër shëndetësore.

Me traktor rreth e përçark Evropës



Fermeri nga Austria, Kurt Kluckner, me një traktor tashmë tre muaj udhëton nëpër Evropë. Momentalisht gjendet në Kastamonu të Turqisë, ndërsa ky 60 vjeçar tha se në muajin prill vendosi të udhëtojë nëpër Evropë. Ai në traktor ngjiti edhe një rimorkio me të cilën deri tani ka kaluar në Gjermani, Poloni, Lituani, Islandë, Rusi, Sllovaki, Hungari dhe Rumani. Në një bisedë me AA tha se pas Turqisë do të vizitojë Gjeorgjinë, ndërsa më pas edhe Bullgarinë. Planifikon të kalojë 14.500 kilometra pas çka kthehet në vendlindjen e tij. Sipas tij, deri tani ka kaluar 8.200 kilometra.

Fëmijët duhet të qëndrojnë zbathur

Fëmijët duhet të qëndrojnë zbathur më shpesh. Qoftë në natyrë, ashtu edhe në shtëpi, qëndrimi zbathur ndihmon shumë edhe në zhvillimin motorik të trupit. Veçanërisht përmirëson ndjeshëm ekuilibrin por edhe startin atletik, apo edhe hedhjet. Përtej benefiteve në aspektin postural dhe zhvillimin e lëvizjeve, të qëndrosh zbathur në bar ndihmon shumë forcimin e imunitetit, por edhe në mikroqarkullim më të mirë të gjakut.

Mjekët vijnë të theksojnë se njeriu ka lindur në natyrë dhe duhet të rikthehet të gëzojë pak

më tepër të mirat e saj, pasi kjo është gjëja më natyrale dhe e shëndetshme. Konkluzioni është arritur falë studimeve të universitetit gjerman Jena dhe është publikuar në revistën 'Kufijtë e Pediatrisë'. Kërkesit kanë marrë në studim rreth një mijë fëmijë gjermanë, dhe një mijë të tjerë nga Afrika e Jugut.

Grupi i dytë ka shfaqur aftësi shumë më të larta në atletikë, kryesisht në ekuilibër, kërcim si larti dhe në sprint. Fëmijët afrikanë pjesën më të madhe të kohës qëndronin zbathur, ndryshe nga fëmijët gjermanë që kanë adoptuar



natyrisht kulturën perëndimore duke evituar në maksimum këtë praktikë. Ndoshta kjo është edhe

një ndër arsyt përse afrikanët janë gjithnjë shumë të zotë në garat atletike.

LIGA E KAMPIONËVE, KUALIFIKIM MES DRITHËRIMASH PËR SHKËNDIJËN

OSMANI: HUMBJE QË NA DHEMB TË GJITHËVE

Kualifikim mes drithërimit për Shkëndijën e Tetovës që në Uells vuajti shumë pasi u mposht me rezultatin 4-0 nga britanikët e The Neë Saints, duke vënë në rrezik kualifikimin dhe duke avancuar për më tej vetëm falë fitores 5-0 në ndeshjen e parë në Shkup



Shkup, 18 korrik - Skuadra e Shkëndijës ka vijuar rrugën e saj në Ligën e Kampionëve edhe pse është mundur me shifrat e thella në Uells. Sfidat mes TNS dhe Shkëndijës është mbyllur 4-0 në favor të uellsianëve. Kuqezinjtë kanë kaluar momente të vështira në transfertë, por kualifikimi u bë realitet falë ndeshjes së një jave më parë në shtëpi. Kampionët e Maqedonisë ishin të pafuqishëm ndaj skuadrës nga Uells, ndërsa duhet thënë se kualifikimi ishte me shumë fat. Ndryshe, trajneri Qatip Osmani kishte lënë në stol disa nga titullarët, sulmuesit Ibraimi, i cili në përballjen e parë shënoi katër gola dhe Radeskin dhe Shkëndija e vuajti jo pak këtë fakt duke bërë një paraqitje zhgënjyese dhe duke pësuar 3 gola që në pjesën e parë. Ebbë,

Redmond dhe Cabango i dhanë avantazhin e trefishtë skuadrës vendase brenda 35 minutave të para. Megjithatë kuqezinjtë pas një fillimi shumë të dobët arritën ta merrnin veten dhe falë zëvendësimeve të trajnerit Osmani, Shkëndija e rriti disi ritmin në pjesën e dytë. Por në minutën e 6-të shtesë TNS shënoi edhe golin e 4-të me Bryne finalizim që vetëm sa i futi frikën Shkëndijës sepse nuk kishte më kohë dhe kuqezinjtë tetovarë hynë në histori teksa me rezultat të përgjithshëm 5-4, kaluan për herë të parë një xhiro në "Champions League". Pas përfundimit të ndeshjes, trajneri i TNS, Skot Rasko tha se skuadra e tij ka pasur mundësi të shënojë edhe gjashtë gola dhe se tetovarët duhet të jenë të lumtur që pranuan vetëm katër gola.

"Në fund duhet të jemi të zemëruar që nuk arritëm të përmbysim rezultatin nga ndeshja e parë. Ndërsa, kishim mundësi të shënojmë edhe gjashtë gola në portën e Shkëndijës. Ndoshta askush nuk ka pritur një paraqitje të tillë të djemve të mi pas asaj paraqitje në Shkup, por ne e dinim se ajo ka qenë vetëm një ditë e keqe. Në pjesën e parë krijuam epërsi prej 3-0, por u thash lojtarëve që të mos mendojnë në rezultat, por të luajnë sa më mirë të munden. Kishim raste, por arritëm të shënojmë vetëm një. Edhe pse u eliminuam, tani mund të themi se kemi dhënë gjithçka nga vetja, ndërsa kundërshtari shpëtoi", deklaroi Skot Rasko. Ndërkohë, nga KF Shkëndija thonë se rezultati nuk ka qenë ai të cilin e kanë dashur,

por që për herë të parë kalojnë raundin e Çampionëve. "Unë mendoj se rezultati i ndeshjes së parë në Shkup, ndikoi tek lojtarët e mi. Ai rezultat i arritur më dha mundësi të ndryshoj formacionin që në fushë u pa kisha bërë gabim. Megjithatë për Shkëndijën është me rëndësi që është në raundin e dytë të Ligës së Kampionëve. Ky rezultat është një mësim i mirë për ne, pasi vetvetiu dhe fillimi i lojës u pa se ne nuk e kishim afërsisht agresiv që rezultoi me humbjen e thellë, humbje që na dhem të gjithëve. Do të mundohemi të mësojmë nga këto gabime dhe mos të përsëritet kjo që na ndodhi sot", deklaroi trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani.

SIPAS MEDIAVE VENDORE

Gjorgjioski largohet nga posti i FFM-së?



Shkup, 18 korrik - Ilčo Gjorgjioski sot (e enjte) pritet që të zyrtarizojë vendimin rreth tërheqjes së tij nga posti i kryetarit të Federatës Futbollistike të Maqedonisë. Vendimin e tij pritet që Gjorgjioski ta shpalojë gjatë ditës së sotme kur është caktuar të mbahet mbledhja e Këshillit Drejtues të FFM-së, në orën 12.00. Gjorgjioski plot 6 vite drejton "Shtëpinë e Futbollit" në Maqedoni, ndërsa para tij në post të kryetarit të FFM-së ishin edhe Lubisav Ivanov, Llambe Arnaudov dhe Harallampie Haxhiristeski. Ndërkohë, mediat vendore informojnë se Gjorgjioski, pasi që të largohet nga futbolli vendor, do të nis punën e tij të re si këshilltarë në kabinetin e presidentit të UEFA-s, Aleksandar Çeferin.

Klubi anglez kërkon Januzajn

Në "Botërorin Rusi 2018" Adnan Januzaj u pa vetëm një herë në fushë, por edhe pse një herë ai la gjurmë me super golin e fitores ndaj Anglisë. Mesfushori i kombëtares belge me këtë paraqitje shumë të mirë bëri që disa klube të interesoheshin për shërbimet e tij. Aktualisht mesfushori është lojtar i Real Sociedadit. Sipas "Daily Mail" Evertoni është një nga klubet që dëshiron shërbimet e 23-vjeçarit. Me Real Sociedad, Januzaj ka luajtur 28 ndeshje, ku 3 herë ka gjetur rrugën drejt portës.

FC SHKUPI U ELIMINUA NGA GLLAZGOU RENXHERS

Broja: Dhamë maksimumin, por edhe fituam përvojë!



Shkup, 18 korrik - Skuadra e Gllazgou Rengjers ka kaluar në raundin e dytë kualifikues të Liga Evropës pasi ka barazuar pa gola me FC Shkupin në ndeshjen e cila u zhvillua në arenën "Filipi i dytë" në Shkup, para më shumë se shtatë mijë shikuesve. Mysafirëve nga Britania e Madhe u mjaftoi rezultati 2-0 që e siguruan në ndeshjen e parë që u zhvillua në Skoci, derisa edhe përkundër eliminimit FC Shkupi në të dyja përballjet bëri një paraqitje të mirë duke dëshmuar se mund të bartet edhe me skuadra siç është Renghers. "Ishte një kundërshtarë me histori të

madhe, mirëpo besoj se kemi dhënë maksimumin dhe se kemi dalë pozitiv nga këto dy ndeshje. Ishte një kundërshtarë shumë i madh, mirëpo besoj se në fushë nuk u pa edhe aq shumë dallimi. Edhe unë mendoj se ekipi më i mirë shkoi më tutje, edhe pse ne edhe njëherë përsëris se dhamë më të mirën nga vetja dhe mund të them se kemi përfituar përvojë nga këto dy përballje", tha Rron Broja në konferencën për shtyp pas ndeshjes. "Urime për Gllazgou Renghersin për plasmanin në raundin e dytë. Urime edhe për lojtarët e mi. Mendoj se bëmë një paraqitje

të mirë dhe më e rëndësishme është se dëshmuam se edhe në Maqedoni luhet futboll kualitativ. Ne u eliminuam, por Shkupi fitoi shumë nga kjo paraqitje në Liga Evropë", deklaroi trajneri i FC Shkupi, Zekirja Ramadani. "Krijuam shumë rast, por për fat të keq nuk e kishim hapin përfundimtar. Sigurisht se jam i kënaqur me plasmanin. Sinqerisht pash dy fytyra të skuadrës sime, kundërshtarit në fillim dhe në fund kur ishte më e organizuar. Neve na ngelet që të përmirësojmë lojën tonë në ndeshjet e ardhshme", deklaroi trajneri i Gllazgou Rengher, Stiven Xherard.

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RM numër 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17 dhe 51/18), neni 15 paragrafi 1 alineja 7, të Statutit të IP Qendra për punë sociale – Demir Hisar dhe Vendimi i Këshillit drejtues nr. 02-55/18 të sjellë më datë 18.07.2018, Këshilli drejtues pranë IP Qendra për punë sociale – Demir Hisar publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra për punë sociale Demir Hisar

- Kandidatët e interesuar duhet ti përbushin kushtet në vijim të përcaktuara me ligj:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Të ketë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VIII/1 e përgatitjes profesionale apo me së paku 240 kredi sipas SETK, nga profilet arsimore në vijim: punëtorë social i diplomuar, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog;
 - Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit;
 - Të parashtrijë program të përgatitur për udhëheqje me institucionin Neto roga është në vlerë prej 26.574,00 denarë.
- Kandidatët duhet ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
 - Certifikatë të shtetësisë
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
 - Dëshmi për arsimin përkatës sipëror të mbaruar certifikatë apo diplomë;
 - Vërtetim për përvojë pune pas diplomimit;
 - Certifikatë përkatëse në pranuar ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet
 - Program të përgatitur për udhëheqje me institucionin
- Dokumentet dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter.
- Shpallja publike zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentet e pakompletuara dhe jo në kohë të dorëzuara nuk do të shqyrtohen.
- Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen deri të Këshilli drejtues i IP Qendra për punë sociale – Demir Hisar në adresën në vijim, rr. "Marshall Tito" p.n – Demir Hisar (me shenjë për shpalljen për zgjedhje të drejtorit).

Orari i kohës së punës: 40 orë pune në javë, orar fleksibil të punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 7.30/8.30 deri në ora 15.30/16.30.

VËREJTE: Kandidati për drejtor i cili do të zgjidhet për drejtor deri më 01 shtator 2018 obligohet që të përbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij. Kandidati obligohet të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare të shënuara më poshtë ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS – së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
- FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose,
- BULATS – së paku 60 pikë

Drejtori i cili nuk do të përbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati. IP Qendra për punë sociale – Demir Hisar KËSHILLI DREJTUES

Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 alineja 5 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17), neni 26 paragrafi 1 alineja 5 e Statutit të IPKÇF "VTORI SEPTEMVRI" – Demir Hisar, Këshilli drejtues i IPKÇF "VTORI SEPTEMVRI" Demir Hisar publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPKÇF "VTORI SEPTEMVRI" Demir Hisar

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj dhe kushteve të përcaktuara në nenin 142 të këtij ligji personi – kandidati është me arsim sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VIII të mbaruar) dhe përbushë kushtet e caktuara në nenin 136 të këtij ligji për edukator, punëtor profesional, bashkëpunëtor profesional, person me fakultet filologjik të mbaruar – programi studimor mësimor dhe studime të specializuara për pedagog parashkollor, jurist, sociolog dhe ekonomist me arsim sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VIII të mbaruar) dhe me minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit dhe posedon licencë valide për drejtor të institucionit për fëmijë.

Kandidati për drejtor të institucionit publik për fëmijë obligohet të parashtrijë edhe Program për punë të institucionit publik.

Shpallja publike zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të saj në shtypin ditor duke mos konsideruar ditën e publikimit.

Krahas kushteve të theksuara të posaçme kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e përgjithshme me ligj.

Kandidatët duhet të parashtrijë:

- Lutje;
 - Biografi të shkurtë;
 - Diplomë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter);
 - Certifikatë të shtetësisë (jo më të vjetër se 6 muaj);
 - Certifikatë mjeku (jo më të vjetër se 6 muaj);
 - Vërtetim për përvojën e punës;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose vendim i plotfuqishëm gjyqësor me çka është i dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqpërdorim të personit të mitur dhe abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
 - Licencë për drejtor dhe
 - Program për punë të institucionit publik.
- Dokumentet të parashtrihen në adresën në vijim:

IPKÇF "VTORI SEPTEMVRI" Demir Hisar rr. "Marshall Tito" nr. 16, Demir Hisar me shenjë "për shpallje publike". Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Këshilli drejtues i IPKÇF "VTORI SEPTEMVRI" Demir Hisar

Në bazë të nenit 14 par.1 dhe neni 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gaz.zyrtare e RM nr.167/15-tekst i pastruar), neni 142 nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (Gaz.zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18), dhe Pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-2481/1 të datës 22.02.2018, Drejtori i IPKÇF "Goce Dellçev" Vinicë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM ME KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS

1. Një (1) person në vendin e punës **edukator** për fëmijë prej moshës 2-6 vjet me kohë të pacaktuar të punës Shkalla e arsimit: Profesor i diplomuar për edukatë parashkollore, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukatë parashkollore - me 240 kredi sipas EKTS apo arsim të lartë të mbaruar shkalla VIII/1 apo me arsim të lartë përkatës të mbaruar për edukatorë dhe licencë të vlefshme për edukatorë

- me ose pa përvojë pune
 - rroga mujore neto me PLP: 18.510,00 den, me PSP 19.581, 00 den.
 - orari ditor i punës: nga ora 7-15 ora, nga të cilat 6 orë pune më fëmijë
2. Dy (2) persona në vendin e punës **përkëdhelës** me kohë të pacaktuar të punës Shkalla e arsimit: të mbaruar arsimin e mesëm katër vjeçar dhe licencë të vlefshme për përkëdhelës
- me ose pa përvojë pune
 - rroga mujore neto: 14.779, 00 den.
 - orari ditor i punës: nga ora 8-16 ora, dhe nga ora 10-18 ora nga të cilat 7 orë pune më fëmijë
3. Një (1) person në vendin e punës **Mirëmbajtës të higjienës** me kohë të pacaktuar të punës Shkalla e arsimit: të mbaruar arsimin fillor ose të mesëm sipas kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe 180 ose 240 kredi të arritura sipas ECVET ose MKSOO.
- me ose pa përvojë pune
 - rroga mujore neto: 12.008,00 denarë
 - orari ditor i punës: me ndërime prej ora 5:30-13:30 dhe prej ora 10:00-18:00

Orari javor i punës për të gjitha vendet e punës : 40 orë (8 orë në ditë nga e hëna deri të premtën)

Së bashku me Fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Dëshmi për arsim të mbaruar,
- Dëshmi për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik,
- Certifikatë shtetësie
- Dokument që nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Dokument që nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

Shpallja zgjat pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Lutja dhe dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri tek IPKÇF "Goce Dellçev" Vinicë, rr. "Stiv Naumov" pn, Vinicë. Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrihen në afatin e vërtetuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do ti përbajnë dokumentet e kërkuara, do të llogariten si jo në kohë dhe të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen

UD drejtori
Natasha Anakieva Dimitrova

Në bazë të Vendimit të kryetarit të komunës së Çashkës Nr. 09 – 1058/ 2 prej 29.06.2018 dhe në bazë të nenit 126, paragrafi 1, pika 7 nga Ligji për arsim fillorë (Gazeta zyrtare e R.M nr 103/8..... dhe 67/2017), Këshilli i shkollës fillore "LIRIA" nga f. Jabollçishtë i Epërm shpallë:

KONKURS

Për zgjedhjen e drejtorit të shkollës fillore LIRIA f. Jabollçishtë i Epërm - Çashkë Kushtet :

Për drejtorë të shkollës fillore zgjidhet personi i cili disponon së paku diplomë për arsimin e lartë, i plotëson kushtet për arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollë fillore, të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në procesin edukativo – arsimorë si dhe provimin e dhënë për drejtorë.

Të drejtë aplikimi kanë edhe kandidatët pa provim të dhënë për drejtorë me kusht që në afat prej një viti ta kalojë provimin për drejtorë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Biografi e shkurtë (CV)
- Të jetë shtetas i R.M
- Të ketë mbaruar arsim të lartë që i plotëson kushtet për arsimtar ose bashkëpunëtor profesional në shkollën fillore
- Vërtetim për përvojë pune (së paku 5 vite përvojë pune në arsim)
- Vërtetim se kandidati e kaloi provimin për drejtorë
- Vërtetim se në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi apo sanksion kundërvajtës ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës
- Vërtetim mjekësorë se kandidati është i aftë për punë.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën:

Sh.F "LIRIA" f. Jabollçishtë i Epërm, komuna e Çashkës

Konkursi do të jetë i hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit

Zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditëve.

Këshilli i shkollës fillore LIRIA
f. Jabollçishtë i Epërm



Republika e Maqedonisë Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100

Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopište, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: **15808**
Nr. **28-39/18** nga **16.07.2018**

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të varrezave qendrore të fshatit në PK2183, KK Dobri Doll, Komuna e Sopištes – Shkup.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të varrezave qendrore të fshatit në PK2183, KK Dobri Doll, Komuna e Sopištes – Shkup.

Përfshirja planore dokument për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të varrezave qendrore të fshatit në PK2183, KK Dobri Doll, Komuna e Sopištes – Shkup është me sipërfaqe prej **17 934.10 m2**.

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **23.07.2018 në ora 10.00**.

6. Anketa publike do të zgjasë deri më **27.07.2018**, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejte, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopište
Stefçe Trpkovski



Republika e Maqedonisë Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100

Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopište, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: **14728**
Nr. **28-33/17** nga **06.06.2018**

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për PK 728, KK Rakotinci për qëllim G4 – depo të materialeve ndërtimore, Komuna e Sopištes.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për PK 728, KK Rakotinci për qëllim G4 – depo të materialeve ndërtimore, Komuna e Sopištes.

Përfshirja planore dokument për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për PK 728, KK Rakotinci për qëllim G4 – depo të materialeve ndërtimore, Komuna e Sopištes është me sipërfaqe prej **18 631 m2**.

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **23.07.2018 në ora 11.00**.

6. Anketa publike do të zgjasë deri më **27.07.2018**, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejte, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopište
Stefçe Trpkovski

I nr. 1823/2017

SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016) Përmbaruesi **Aleksandar Kuzmanovski** nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori **Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup** nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përmbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjve **1. Xhezmi Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë **2. Gjuzazije Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **3. Fatime Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe **borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai** nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 13.07.2018:

FTON

Borxhlinjtë **Xhezmi Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **Gjuzazije Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **Fatime Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë për shkak të dorëzimit të:

-Procesverbalit për shitje të patundshmërisë përmes ankandit publik me gojë në bazë të nenit 186 paragrafi (4) të LP I nr. 1823/2017 të datës 26.06.2018

-Konkluzion për Shitjen e dytë publike me gojë në bazë të nenit 179 paragrafi (1), neni 181 paragrafi (1) dhe neni 182 paragrafi (1) e LP P. nr. 1823/2017 të datës 04.07.2018.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.

PARALAJMËROHEN borxhlinjtë **Xhezmi Emro**, **Gjuzazije Emro**, **Fatime Emro**, se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzim i rregullit dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

KJO PARAQET SHPALLJEN E TRETË.

Përmbarues
Aleksandar Kuzmanovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+ Pr+1+Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

DREJTOR I NP-“SHKUPI VJETËR”

Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5
Tel: 02/2616-019 | faks: 02/2616-867

Nr. _____ prej _____ vit

Në bazë të nenit 39, neni 67 dhe neni 24, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponimin me mallrat në pronësi shtetërore dhe me mallrat në pronësi të komunës (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15) dhe Raporti për vlerësimin e vlerësimit të hapësirës afariste në rr. Çairska pn Shkup – Çair pronësi e Komunës së Çairit përpiluar nga SHPSH KARANFILOFSKI PROCENKA SHPKNPJ SHKUP, (nr. 0404-114/18 nga data 16.11.2018) Komisioni për realizimin e ankandit publik elektronik për shitjen e automjeteve motorike të udhëtimit jep këtë:

SHPALLJE nr. 1/2018 për konkurs për dhënie me qira të mallit të patundshëm (hapësirë afariste) në mënyrë të ankandit publik elektronik (për herë të parë)

1. Lëndë e dhënies me qira

Lëndë e ankandit elektronik publik është dhënia me qira e mallit të patundshëm, hapësirë afariste e cila gjendet në rr. Çairska pn Shkup – Çair, PK 7556 KK Qendër 1, pronësi e Komunës së Çairit (fletë pronësi nr. 44769 KK Qendër 1), në pajtim me vendimin për dhënie të objekteve afariste dhe hapësirave afariste në pronësi të Komunës së Çairit, në dispozicion dhe menaxhim të Ndërmarrjes publike “Shkupi i Vjetër” nr. 08-407/22 nga data 23.02.2018 e miratuar nga Këshilli i Komunës së Çairit.

2. Të dhënat për objektin (hapësirë afariste), çmimi fillestar i qirasë, afati i dorëzimit dhe mënyrë së dorëzimit të fletëparaqitjes, kushtet për pjesëmarrje, garancia bankare, data dhe ora e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit publik.

Të dhënat për objektin (hapësirë afariste) çmimi fillestar i qirasë, garancia bankare, hapi minimal dhe ora e mbajtjes të ankandit publik të mallit të patundshëm – hapësirës afariste, janë dhënë në tabelë dhe atë:

Pasqyrë tabelore:

NR.Ren	Të dhënat për objektin të hapësirës afariste	Vlera e përgjithshme në euro	Vlera e përgjithshme në denarë	Qira fillestare mujore në denarë	Garancia bankare 2%	Ora e fillimi
1.	Mall i patundshëm: objekti afarist, i cili gjendet në rr. Çairska pn. Shkup – Çair PK 7556 KK Qendër 1, objekti 1, përdhese, me dedikim: objekt në menaxhim tjetër (Hapësirë afariste) me sipërfaqe prej 145 m2.	69.462,00	4.272.246,00	21.361,00	85.485,00	12:00

(në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin dhe disponimin me mallra në pronësi shtetërore dhe mallra në pronësi të komunës Gz. Zyrtare e RM-së nr. 78 dhe 153 të vitit 2015 Latësia e qirasë mujore fillestare arrin 0,5 % nga vlera e vlerësuar e mallit të patundshëm)

2. Data e mbajtjes së ankandit publik

Ankandit publik do të mbahet me datë 30.07.2018 (e hënë) me fillim në ora 12:00.

Ankandit publik do të mbahet në mënyrë elektronike në këtë ueb faqe [www.http://cair.gov.mk](http://cair.gov.mk)

3. E drejta e pjesëmarrjes në ankandin publik

Të drejtë pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë të interesuarit personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj të cilët mund të arrijnë me pronësi të mallrave të tundshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin dhe të cilët i përmbushin kushtet e dhëna në shpallje.

Rishikimin e objektit i cili është lëndë e ankandit publik, subjektet e interesuara do të mund ta bëjnë në Komunën e Çairit me datë 25.07.2018 në ora 10.00 deri 14:00

5. Kushtet për pjesëmarrje në ankandin publik

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik (në formë të shkruar, në të cilën është shënuar se cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes) e kompletuar me këto dëshmi (të parashtuar në origjinal ose fotokopje të verifikuar në noter):

1. Fletëparaqitje nga parashtruesi, në të cilën janë shënuar të dhënat për të cilën bëhet fjalë e njëjta, si dhe çka dorëzohet në shtojcë të fletëparaqitjes (cilat dokumente);
2. Dëshmi për garanci bankare për seriozitet të ofertës në lartësi prej 2% nga vlera e vlerësuar të mallit të tundshëm; Paga të bëhet në llogarinë e kasafortës: 200003169976870, deponues i Stopanska banka SHA Shkup; titulli dhe selia e pranuesit: Buxheti i Ndërmarrjes publike Shkupi i Vjetër – Shkup,
3. Për persona fizik letër njoftimi ose dokument udhëtimi;
4. Për persona juridik për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës;
5. Autorizim i rregullt për autorizuesin i cili do ta përfaqësojë personin juridik, gjegjësisht dëshmi për vetinë e personit përgjegjës të autorizuar të personit juridik dhe
6. E-Mailadresa e parashtruesit të fletëparaqitjes, nëpërmjet të së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do të dërgohen në afat prej tre dite nga data e dorëzimit të ofertës, emri i shfrytëzuesit dhe shifra për pjesëmarrje në ankand publik gjegjësisht qasje në faqen e internetit në të cilën do të realizohet ankandit elektronik publik.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për të cilën do të njoftohen në mënyrë elektronike (për parashtruesin e fletëparaqitjes i cili do të dorëzojë e-mail adresë të gabuar NP Shkupi Vjetër nuk ka për obligim që të pranojë dhe bëjë korrigjim të së njëjtës).

Parashtruesit e fletëparaqitjeve është e nevojshme që të dorëzojnë në fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik edhe fotokopje nga llogaria personale e transaksioneve në të cilën do të mundet të kthehen depoziti për pjesëmarrje në ankand publik.

6. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik është dhjetë ditë nga dita e shpalljes së konkursit, përmbullur me datën 28.07.2018 në ora 15.00.

7. Garancia bankare

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditë nga dita e mbajtjes së ankandit publik ndërsa garancia bankare ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditë nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

8. Procedura

Ankandit publik fillon me shpalljen e çmimit të qirasë në fillim të muajit për hapësirë afariste e cila është lëndë e ankandit publik dhe realizohet nëpërmjet ankandit nga ana e pjesëmarrësve.

Ankandit publik do të mbahet edhe përdërisa pas shpalljes është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili i përmbush kushtet e dhëna në Shpallje dhe e ka dhënë çmimin fillestar.

Në pesë minutat e parë të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë gjegjësisht ta zmadojnë çmimin për qiranë mujore.

Ankandit publik llogaritet që ka përfunduar në momentin e skadimit të kohës së përcaktuar në shpallje, gjatë së cilës nëse në skadimin e dy minutave të fundit nga koha e përcaktuar për kohëzgjatjen e ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë oferta, afati përfundimtar për kryerjen e ankandit publik vazhdohet për edhe dy minuta ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej 2 minutave të ardhshme nuk ka ofertë të re të dhënë. Ankandit publik vazhdon pakufi, deri sa në interval kohorë prej dy minutave ka ofertë të re.

Përdërisa në pesë minutat e parë të ankandit publik nuk është pranuar oferta, gjegjësisht nuk është dhënë ofertë më e lartë nga pjesëmarrësi i ankandit publik, vlera e qirasë mujore zvogëlohet për 2 % nga vlera e vlerësuar pasi që pjesëmarrësit në ankandit publik përsëri ka mundësi ta pranojë gjegjësisht ta zmadojnë çmimin e qirasë mujore pastaj pa u kufizuar në hapin minimal të rritjes. Nëse në skadimin e dy minutave të fundit nga pesë minutat e dyta nga ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për mbarimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk ka të dhënë ofertë të re. Nëse në Kohëzgjatje prej 5 minutave përsëri nuk ka ofertë, vlera e qirasë mujore, përsëri zvogëlohet për 2% nga vlerat vlerësuar fillestare.

Për ofertues më të volitshëm llogaritet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmim përfundimtar i cili paraqet çmimin më të ulët.

Komisioni pas mbarimit të ankandit publik përpilon procesverbal për realizimin e ankandit publik i cili dorëzohet deri tek të gjithë pjesëmarrësit e ankandit publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë të ankesës vetëm në lidhje me procedurën për ankand publik, në afat prej tre ditësh nga mbajtja e ankandit publik deri te komisioni i cili vendos ankesat me aktvendim në afat prej 5 dite nga pranimi i ankesës.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje është i obliguar që ti paguaj mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar për qiranë mujore, ndërsa nëse nuk i paguan në këtë afat nuk do të trajtohet drejt lidhjes së kontratës, garancia bankare do të aktivizohet, ndërsa ofertuesi në periudhë prej 1 viti nuk do të mund të marrë pjesë në secilin ankand të ardhshëm publik për dhënie me qira të mallit të patundshëm.

Me ofertuesin më të volitshëm, në afat prej 5 ditë pune pas kryerjes së pagesës të çmimit të qirasë mujore, lidhet Kontratë për dhënie me qira të mallit të patundshëm.

Obligimin për shpenzime për solemnizimin e kontratës bie në barrë të blerësit.

Kjo shpallje do të shpallet në ueb faqen e Komunës së Çairit [www.http://cair.gov.mk](http://cair.gov.mk)

Drejtor i N.P. “Shkupi i Vjetër”
Rami Qerimi

Koha
E përditshme informative

<http://www.koha.mk>

koha@koha.com.mk
marketing@koha.com.mk

Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;

Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhese, Shkup

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPLL

Draft – A leje të integruar ekologjike për GD GRANIT AD Shkup – Kërçovë

Në përputhje me nenin 96 alineja 1 dhe nenin 107 dhe alineja 13 e Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16) deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar kërkesë për marrje të A-Lejes së integruar ekologjike nr. UPI-11/3-242 e vitit 22.02.2017

Dorëzues i kërkesës:
GD GRANIT AD Shkup – Kërçovë
Republika e Maqedonisë

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
PK nr. 5729, 5730, 5739, 5735, 5740, 5741, 5744, 5743, 5742, 6712, 1529/1

Personi për kontakt:
Goran Millovanovic

Kategoria e instalacionit:
Shtojca 1 pika
3. Industria e mineraleve
3.5 Bazat stacionare të asfaltit

Shtojca 2 pika:
3.3 Baza stacionare të betonit me kapacitete të siloseve mbi 50 m3

Lloji i aktivitetit:
Prodhimi i asfaltit dhe betonit me pajisjet shoqëruese

Kërkesa në formë të shtypur, do të jetë e ekspozuar, për shqyrtim për të interesuarit në afat prej 14 ditëve që nga dita e daljes së kësaj Shpalljeje në shtypin ditor:

në hapësirat e:
Komunës së Kërçovës 10 – 16:00

Në të njëjtën kohë, kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor www.moep.gov.mk
Të interesuarit informata më të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në tel. 076 456 717 (e-mail: f.balieu@moep.gov.mk).
Të interesuarit në afat prej 14 ditëve që nga data e shpalljes së draft lejes, kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtjet dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi “Goce Dellçev” nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

ZBULOHEK FJALIMI I POGBAS PARA NDESHJES ME ARGJENTINËN

"SOT, NE I VRASIM ATA, MESSI APO JO MESSI"



Pol Pogba mbajti një fjalim frymëzues përpara bashkëlojtarëve të Francës, kur po përgatiteshin të dilnin në fushë dhe të luanin 1/8 finale kundër Argjentinës së Lionel Messit. Ai është futur në mes të lojtarëve të tjerë dhe u ka thënë me zë të fortë: "Sot, ne i vrasim ata, Messi apo jo Messi", u kishte thënë Pogba shokëve të tij

Franca mori titullin e saj të dytë botëror falë fitores 4-2 kundër Kroacisë, në finalen e madhe të Moskës, teksa ndikimi i Pol Pogba në dhomën e zhveshjes ka qenë i dukshëm, edhe në mes të festimeve. Pogba bëri një numër fjalimesh para skuadrës së "gjelave" në rrugën drejt triumfit përfundimtar në "Rusia 2018", por spikat ai më frymëzuesi dhe emocionuesi, para fitores 4-3 ndaj Argjentinës së Lionel Messit,

në Kazan. "Unë dua të shoh luftëtarë në fushë, – tha Pogba për shokët e tij, në një skenë të dokumentarit të transmetuar nga "TF1". – Nuk dua të kthehem në shtëpi! Do ta mbarojmë të lumtur këtë Botëror, dua të luaj sonte, të vdes në fushë. Të gjithë së bashku, dua njerëz, luftëtarë, ushtarë. Sot, ne do t'i vrasim ata. Messi apo jo Messi, nuk më intereson! Ne kemi ardhur për ta fituar këtë Kupë Bote!", u ka thënë Pogba bashkëlojtarëve të tij. Mesfushori i Mançester Junajtedit, ishte po i tillë frymëzues me fjalimin e tij, para se Franca të mundte Uruguain 2-0, për një vend në gjysmëfinale të Kupës së Botës. "Kjo është ajo që duhet të bëjmë, nuk ka kthim më, – tha Pogba. – Do të vazhdojmë përpara, do të shkojmë gjithë rrugës!", u kishte thënë Pogba shokëve të tij. "Të shohim më 15 korrik, të gjithë së bashku! Sot, Blaise Matuidi, i cili u pezullua për përplasjen e çerek-

finale, si rezultat i akumulimit të kartonëve të verdhë, është në stol. Ai është i zhgënjyer, është i mërziur, dëshiron të luajë më shumë se kushdo tjetër në fushë! Ky është një sinjal për djemtë, që të luftojnë fort sot! Ai nuk do të jetë në fushë, por do të jetë sikur të ishte me ne. Të gjithë duhet të bëjnë lojën e tyre, edhe për Matuidin! Dhe tani, ne do të luftojmë për partnerët tanë, siç kemi bërë edhe më parë. Të luajmë si ndaj Argjentinës dhe ndoshta më shumë, gjithnjë e më mirë. Duhet të mundim më të mirët për të qenë më të mirët!". Pogba, shpesh objektiv i kritikëve, është një nga emrat që përflitet si kapiten i mundshëm për Mançester Junajtedin në sezonin e ardhshëm, pas pensionimit të Mikael Karrik, ndërsa trajneri Hoze Murinjo me siguri do të jetë i kënaqur ta shohë yllin e tij të mesfushës që tregon këtë lloj lidhjeje prej lideri.

GJEST I MADH I LOJTARËVE KROAT

Dhurojnë të gjitha premitë për një fondacion të fëmijëve

Trajneri i Kroacisë, Zlatko Dalçiu është drejtuar të gjithë politikanëve të vendit të tij me një letër të hapur, ku iu kërkon të mos përdorin arritjet e kombëtares për arsye politike. Dalçiu iu ka thënë që politikanët s'do lejohen të bëjnë foto me lojtarët duke qenë se ata janë shkaktarë të gjendjes së vështirë ekonomike në Kroaci dhe emigrimit masiv. Lojtarë dhe stafi i Kombëtares së Kroacisë kanë vendosur të dhurojnë premitë e fituara në Botëror (rreth 23 milionë euro) për një fondacion të fëmijëve.

"I shkruaj këto rreshta për shkak të situatës së vështirë në Kroaci. Kroacia është vendi më i varfër në Bashkimin Evropian (nga 28 vende, është i treti me GDP më të ulët për frymë, me 11,700 euro,



vetëm pas Bullgarisë dhe Rumani-së), sunduar nga anëtarët e asaj që ka qenë konsideruar si një organizatë kriminale. Kroacia është një vend nga i cili miliona njerëz kanë ikur në 20 vitet e fundit. Sot në Kroaci, pensionistët tanë nuk janë

në gjendje për të përmbushur nevojat e tyre themelore, të rinjtë nuk mund të përballojë shkollimin, shëndetësia po falimenton dhe gjyqësori mbron biznesin e madh dhe të korruptuar. I kërkoj të gjithë politikanët dhe përfaqësuesit e auto-

riteteve që kanë çuar njerëzit në ferr të mjerimit, dëshpërimit dhe varfëria që të qëndrojnë larg nga përfaqësuesja e Kroacisë. Ju nuk jeni të mirëpritur në veshjet tona, nuk duam të marrim fotografi ose të merremi me ju. Ju jeni ata që e bënë Kroacinë njerëzit më të varfër në Evropë", shkruan në letërën e tij Zlatko Dalçiu, e nënshkruar edhe nga vetë lojtarët e Kroacisë. "Kemi fëmijë që nuk e kanë parë kurrë detin dhe Kroacia ka më shumë se një mijë kilometra vijë bregdetare (mbi 1,880km). Kemi fëmijë që shkojnë të uritur në shtat, sepse prindërit e tyre, të papunë, nuk kanë çka t'u japin për të ngrënë. Njerëzit që e kanë bërë këtë në vendin tonë nuk janë të mirëpritur. Ju lutemi respektoni vendimin tonë,

mos mbani fanella të futbollistëve tanë, mos përdorni suksesin tonë për promovimin tuaj.

Pra, ju minoni vlerën e punës tonë. I gjithë ekipi raporton se ata do të dhurojnë çmimet e Kupës Botërore të Rusisë në një fondacion për fëmijët kroatë. Ky fondacion do të financojë pushimet verore për ata fëmijë që nuk kanë parë kurrë Detin Adriatik. Anëtarët e ekipit kroat futbollit janë me popullin e Kroacisë dhe do të bëjë atë që ata mund të ndihmojnë, përtej fitoreve. Të gjithë fëmijët kroatë do të kenë mundësinë të kalojnë të paktën shtatë ditë në bregdetin kroat. Kjo është më së paku që mund të bëjmë për më të prekshmit", përfundon shkërimin e tij Dalçiu.

Heronjve anglezë u dedikohen vende parkingu

Heronjve anglezë të Kupës së Botës u është dhënë një parking i dedikuar në hapësirat e supermarketeve si pjesë e një iniciative nga Lidl. Kompania gjermane e marketeve ka vende të rezervuara për Tre Luanët, duke u siguruar se Sautgejt, Kin, Pikford dhe Tripper mund të bëjnë pazar sa më rehat në vendlindjet e tyre. Kin ka një vend në Lidl që ndodhet në Çingford, vetëm pak kilometra larg shtëpisë së tij, ndërsa Sautgejt do ta ketë vendin në Kravlej. Pak më në veri, Pikford e ka parkingun e tij në Uashington dhe Tripper në Bury. "Jemi të lumtur që mund të tregojmë vlerësimin tonë për Geret dhe skuadrën e tij të mrekullueshme," deklaroi menaxheri i Lidl, Kristian Hartnagel.



DASHI 21. mars - 20. prill
Ndonëse do të keni keqkuptime të vogla që ju pengojnë, nuk duhet të dekurajoheni pasi në vendin e punës mund të hasni në vështirësi. Kjo ditë ju fton që të mos përhumbeni pas disa diskutimeve të vogla në dashuri.

DEMI 21. prill - 21. maj
Do të rifitoni sigurinë në veten tuaj dhe ky guxim do ju lejojë që të çoni përpara propozime të rëndësishme për bashkëpunëtorët tuaj. Jeni përfshirë në një rrugëtim intensiv, i cili do ju lejojë që të përcaktoni qartë prioritetet në dashuri.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Yjet i mbrojnë të gjithë çiftet e lindura gjatë periudhës së fundit. Do të riktheheni të jeni romantik dhe të dashur dhe kjo edhe për shkak të disa konfirmimeve që keni marrë së fundmi. Në vendin e punës do të merrni propozime të rëndësishme, por do ju duhet të përballeni me pengesa të vogla burokratike.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Duhet të tregoheni të fortë dhe të vendosur në vendin e punës, për shkak se tashmë do të vini në zbatim disa strategji fituese për projektet tuaja. Në dashuri, kjo është një periudhë mjaft e frytshme, ndaj jini kurajoz dhe lëreni veten të lirë ndaj aventurave të reja.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Parashikohet një e mërkurë, gjatë së cilës duhet të tregoheni mjaft të kujdesshëm, me mënyrën tuaj të shprehurit. Do të prireni të jeni tejet agresiv përballë kritikave, por në këtë moment tensionet nuk do të jenë aspak produktive në vendin e punës.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Në dashuri mund të bëni njohje të reja të rëndësishme, por vetëm nëse jeni vërtetë gati të lini pas të kaluarën, do të krijoni diçka të bukur. Nga pikëpamja profesionale, parashikohen bashkëpunime interesante për të gjithë projektet që keni në plan të zbatoni.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Do të përballeni me disa dyshime, të cilat nuk ju lejojnë që të jetoni qetësisht këtë periudhë mjaft të favorshme për dashurinë. Mos u përfshini shumë nga ankthi dhe shmangni thashethemet që dëgjoni nga të tjerët. Kjo është një periudhë mjaft e mirë për të kursyer pak më shumë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Po jetoni një situatë mjaft kaotike nga pikëpamja sentimentale dhe kjo ju bën mjaft nervoz dhe të irrituar. Shmangni marrjen e vendimeve tepër të nxituara. Në vendin e punës, parashikohen probleme të vogla të natyrës organizative.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Parashikohen mundësi të mira për të rizgjuar romantizmin, por duhet të jeni të gatshëm që të plotësoni disa kërkesa të partnerit tuaj. Rigjetja e stabilitetit në çift është e mundur, por vetëm nëpërmjet dialogut dhe mirëkuptimit reciprok. Favorizohen marrëveshjet dhe negociatat.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Duhet të jeni gati që të riktheheni fuqishëm në punë. Nëse keni një çështje që rri pezull, intuita nuk do ju zhgënjëjë. Në dashuri nuk duhet të jeni shumë të hutuar.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Gjetja e kompromisit në vendin e punës, nuk është e lehtë, por duhet të mundoheni që të jeni më të gatshëm dhe fleksibël me kolegët tuaj, për shkak se disa negociata do të jenë të domosdoshme për realizimin e një projekti të mirë. Mbrëmja do të jetë shumë e frytshme për tu kaluar me familjen.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Është një ditë mjaft interesante për të thelluar bashkëpunimet, çështjet e biznesit dhe transaksione të rëndësishme, të cilat do i japin shtysën e duhur karrierës tuaj profesionale. Ky është një moment shumë i mirë për të kultivuar dashurinë, ndaj shfaqni sa më shumë anën tuaj romantike.

Mensur Mamuti	GAZETA FRËNGJE, ORGANIZATORE E GARËS SË ÇIKLIZMIT NË FRANCË (FOTO)	MBISHKRIMI I VARRIT (GREQ.)	GOVATA	PJESË E TRUPIT	SHETET NË AMERIKËN E MESME
GAZETA FRËNGJE, PASARDHËSE E GAZETES ORGANIZATORE TË GARAVE					
RAJON NË JUGPERËNDIM TË PRIZRENIT NË JUG TË KOSOVËS					
MIZOR, DESPOT					
LËNGU I SYRIT					
L				AUSTRIA	OË PESHON ME OKE
FATI, MBARËSIA (BISED.)	PJESË E MOLEKULËS BURGIM				
N					
QËNDRUJ ULUR			ADEM JASHARI		
ENERGJIA	GADISHULLI MALAJAS		LULE OË VIHET NË SHENJË NDERIMI MBI VARR		
KËNGËTARJA BELGE, SELAH				NDRIÇUESËT	Ë
GARA E ÇIKLIZMIT NË FRANCË (FOTO) (PËRFUNDUOI NË DITËN E SOTMË NË V. 1903)					
KOMPOZITORI RUS, STRAVINSKI				KËNGËTARJA TARIFA	
FITUESI I GARAVE TË PARA (FOTO)				KRAHINË INDUSTRIALE NË GJERMANI	
KOHA	GABIM (BISED.) IK				VIDEO LOJA, TORI ...
SH. R.			OKA E PUNUAR LITUMI		NUMRI BINAR (BINARY DIGIT)
LLOJ RËVOLEJE					RIKA PARA NJË SHFAQJEJE METRI
NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE				DËSHMOR	



ZGJIDHJET: L EKIP, OPOJA, TIRAN, LOTI, A, ATOM, NAFKA, RRI, AJ, E, KRA, SJUA, TUR DË FRANS, IGOR, ENEDA, MORIS, GARIN, HATA, TOKI, SHR, ARA, BIT, KOLT, TREMA, OMI, MARTIR.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

9	5	6			4	7													
			2									8			3	7			6
4	2		7		8	5								2					
8							4	9				6			4	2			
		9	8		6	2								7	9	5			
6	7															1	3	7	
	5	8		6			1	9						1					3
					2							5		4		2	9		8
	6	3			5	7	2												4

Shumë i lehtë: 395618472, 786254931, 142379856, 821537649, 539846217, 674921583, 258763194, 917482365, 463195728. Mesatar: 759146823, 842537196, 136829457, 615374289, 327958641, 984261375, 491685732, 573412968, 268793514.

As Maradona, as Messi. Argjentinasi i vënë demit emrin MBAPPE

Këto ditë në Argjentinë ka filluar panairi i famshëm agrokulturore. Ndryshe nga vitet e tjera, edhe pse është edicioni i 150 i këtij panairi, ka rënë në sy një dem 920 kilogramësh. I zoti nuk e ka quajtur as Maradona dhe as Messi, siç mund të pritej, por Mbappe. Sipas traditës, shoqëria rurale që mbron të drejtat e fermerëve,



ve, i vendos një emër prestigjioz një nga kafshëve që më pas do të marrë pjesë në një garë të një kategorie më të lartë që organizohet po në Argjentinë. Ferma që

ka nxjerrë demin e famshëm të quajtur Mbappe e përshkruan atë si një dem me shumë karakter dhe me një paraqitje shumë të mirë.

Lind në avion me ndihmën e personelit

Një pasagjere, një qytetare kanadeze me origjinë marokene, lindi një vajzë në një fluturim me avion nga Casablanca në Montreal. Gruaja, shtatë muajshe shtatzënë, lindi vajzën e saj pak para se të zbriste në Kanada, falë ndihmës së ekuipazhit të fluturimit të kompanisë Royal Air Maroc dhe një pasagjereje tjetër, mjeke. Nëna e re kishte kontraktimet e para disa orë pas ngritjes së avionit. Ajo dhe fëmija u transportuan në spitalin Sainte-Justine në Montreal në gjendje të mirë. Fotoja është publikuar nga faqja "Facebook" e "Royal Air Maroc Fans".



Veturat me dizelë, të padëshirueshëm në Shtutgart nga viti 2019



Qyteti i dy kompanive kryesore automobilistike gjermane, Mercedes dhe Porsche, nga 1 janari i vitit të ardhshëm vendos të ndalojë makinat me motorë diesel me specifika Euro 4 dhe ato më të vjetra.

Duke kujtuar se në fillim të këtij viti, qeveria e qytetit të Hamburgut, qyteti i dytë më i madh në Gjermani, vendosi të ndalojë në trafik disa motorë me naftë në rrugët qendrore që nuk plotësojnë standardin Euro 6, e cila është praktikisht në të gjithë motorët me naftë të prodhuar para vitit 2014.

Shtutgardia për momentin do të zbatojë ndalimin vetëm për motorët dizel me specifikim Euro 4 dhe ato më të vjetra. Megjithatë, nëse masa nuk sjell rezultate të kënaqshme në formë të reduktuara të ndotjes së ajrit apo nëse përqendrimi i oksideve të azotit nuk ulet në përmasat e lejuara deri nga mesi i 2019-ës, nga janari 2020 ndalimi do të zgjatet për automjetet me motorë me naftë me Euro 5. Motorët me naftë që plotësojnë standardin Euro 5 janë prodhuar që nga viti 2009, ato me standardin Euro 6 nga 2014.

Njeriu më me fat në botë

Shoferi i një karroce trirrotëshe, të cilit iu ngulën katër shkopinj bambuje në trup, ka mbijetuar mrekullisht. Ngjarja ndodhi në Hubei, në juglindje të Kinës. 25-vjeçari z. Li u "gozhduar" në pjesën e pasme të një kamioni, natën e së mërkurës. Mjekët kanë arritur të heqin bambutë nga i riu. Megjithatë, ai mbetet në gjendje kritike. Karroca e 25-vjeçarit u rrëzua në kamionin e ngarkuar me shkopinj bambuje rreth orës 10 në Yangxin, qytetin e Huangshi, sipas policisë. Shkopinj të bambusë rrëshqitën nga kamioni për shkak të përplasjes dhe katër prej tyre depërtuan në trupin e Li. Zjarrfikësit ekzaminuan situatën dhe vendosën të shkurtojnë bambu duke përdorur thika



të dorës. "Situata ishte shumë e ndërlikuar. Ne nuk deshëm të shkaktojmë ndonjë dëm tjetër për shoferin", tha shefi i ndihmës Yang Quanwei për Beijing News. Zjarrfikës të tjerë u përpoqën ta

mbanin z. Li të zgjuar gjatë kryerjes së punës së shpëtimit. Shoferi u dërgua në Spitalin Popullor Yangxin ku iu nënshtrua një operacioni në departamentin e kardiokirurgjisë.

1178 - Frederik I (Barbarossa), Perandori i Perandorisë së Shenjtë Romake, kurorëzohet si Mbret i Burgundit.

1626 - Tërmeti në Napoli, Vdesin 10,000 persona.

1650 - Princi Uilhem II okupon Amsterdamin.

1715 - Flota spanjolle me ar dhe argjend zhduket në St Lucie, Florida

1729 - Themelohet qyteti i Baltimorit.

1733 - Shoqata e Masonëve hapin lozhën e parë amerikane në Boston

1824 - Xhoakimo Rosini emërohet menaxher i Teatrit italian në Paris.

1836 - Publikohet gazeta e parë angleze në Havai.

1839 - Robërit e rebeluar marrin nën kontroll anijen për robër, Amistad.

1914 - Austro-Hungaria dhe Rusia shpallin mobilizim.

1938 - Gjen. Metaksas vetëmërohet kryeministër i Greqisë.

1966 - Aeroplanët amerikan bombardojnë zonën e demilitarizuar në Vietnam.

Çifti italian Michele Fucarino dhe Elisa Lazzarini ishin puthur për 3 minuta e 24 sekonda nën ujë në Romë më 2010 për rekordin botëror.



Më 2014 në Sao Paulo të Brazilit 13.577 çiftë ishin puthur në të njëjtën kohë.



Paulo Gabriel da Silva Barros dhe Katyucia Hoshino nga Brazili përbëjnë çiftin më të shkurtër të martuar. Ata së bashku janë të gjatë 181.41 centimetra. Dyshja u martua më 17 shtator 2016.



DY BIONDE DHE PASQYRA

Duke ecur rrugës, dy bionde gjejnë një pasqyrë.

Njëra e merr, e shikon dhe thotë:

- Sa e njohur me duket kjo vajzë!

E merr tjetra dhe shikon:

- Budallaçke, a s'e sheh se jam unë!



Budallallëku është shumë më i rrezikshëm sesa e keqja, sepse e keqja herë pas here bën pushim, kurse budallallëku jo!
(Anatole France)



KALENDARI HISTORIK 19 KORRIK



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS